- Mirëmbajtja kur të dhënat e vektorizuara nuk janë në dispozicion,
- Mirëmbajtja kur të dhënat e vektorizuara janë në dispozicion

Kornizat duhen të kuptohen si rregulla të përgjithshme meqenëse çdo situatë për çdo rrjet lokal duhet të përcaktohet veçanërisht. Dokumenti është poashtu i lidhur me Kornizat për rindërtim pasi azhurimi i planeve të vjetra kadastrale mund të bëhet vetëm gjatë procesit të rregulltë të mirëmbajtjes.

## 2. Efektshmëria e udhëzuesit

Kornizat bëhen efikase menjëherë pasi që procedurat dhe software-i të paraqiten dhe ZKK-ja e interesuar të zotëroj aftësitë e sajë për ti aplikuar këto udhëzime.

## 3. Mirëmbajtja kur të dhënat e vektorizuara nuk janë në dispozicion

### 3.1 Krijimi i Geoworkspace për zonën kadastrale

→ Krijo një Geoëorkspace të ri për çdo zone kadastrale në bazë të **Korniza 2005/14** dhe me karakteristikat vijuese:

- Emri dhe shtegu i Geoworkspace-it:
- Datumi Gjeodetik: KOSOVAREF01

- Importo të gjitha pikat kontrolluese ekzistuese të mundshme duke përdorur GeosPro

Të gjitha ndryshimet pasuese brenda zonës kadastrale janë të kryera në Geoworkspace derisa të bëhet i mundshëm kompletimi i vektorizimit. Më pas të gjitha të dhënat do të eksportohen në **ITF-fajll** dhe, pas transformimit, do të importohen në Geoworkspace-in definitiv të zonës kadastrale.

### 3.2 Hapni projektin e ri të mutacionit (ndërrimit)

→ Hapni një projekt të ri të mutacionit për kërkesat e ndryshimit në të drejtat pronësore (p.sh. nëndarja e parcelës) në bazë të **Korniza për përdorimin e Software-it për Mutacion GeosPro 2005/15**.

Për çdo mutacion(ndërrim), bashkim parcelash të kërkuar duhet të përdoret formulari (shiko kapitullin 6.1) dhe duhet të përcaktohet numri unik i mutacionit. Forma e re e parcelës duhet të diskutohet parmisht me palën/parashtruesin e kërkuesës (në bazë të kufizimeve të Ligjit mbi Planifikim Hapësinor).

### 3.3 Përgatitja e informacioneve të nevojshme kadastrale

→ Gjeoreferenconi hartën kadastrale me RasterEx në bazë të **Korniza2005/08**.

→ Vektorizo parcelat, të cilat përfshihen në ndërrim(mutacion), poashtu edhe të gjitha parcelat e afërta.

Hartat kadastrale që nuk janë të gjeoreferencuara me RasterEx do të jenë të regjistruara në bazë të: **Korniza 2005/08** të regjistrimit të Imazheve në GeoMedia.

Këto të dhëna lokale të prodhuara në këtë mënyrë duhet të përshtaten në sistem më pas.

Kontrollo kualitetin e të dhënavë të vektorizuara:

→ Digitalizo 3 deri në 4 pikë kontrolluese. Sipërfaqja e mutacionit duhet të jetë e përcaktuar brenda këtyre pikave të digitalizuara.

→ Krahaso koordinatat e llogaritura me koordinatat e digjitalizuara:

Shkalla e hartës 1:500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.15m$
Shkalla e hartës 1:1000:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.30m$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.60m$

- Kontrollo vektorizimin nëse diferençat janë më të mëdha:
- Llogaritni disa pikat kufitare të bazuara në matjet ekzistuese
  - Krahasoni me të dhënat e vektorizuara
  - Zëvendësoni definimin e kufinjëve me të dhënat e llogaritura.
  - Nëse diferençat janë shumë të mëdha, mutacionet e mëhershme duhet të kryhen përfundimisht

### **3.4 Definimi i kufinjëve në hartën kadastrale (Mutacioni në zyre)**

Forma e re e parcelës duhet të diskutohet dhe definohet parimisht me pronarin.

→ Llogarit kooordinatat e parcelës së re të definuar në GeosPro në bazë të manualit të GeosPro (Tutorial, Online Help) me përdorimin e **ProCalc / Pikat e ndërprerjes**.

→ Eksportoni dhe transferoni të gjitha koordinatat e parcelës dhe pikat kontrolluese në TCR303 **Korniza 2005/05**

#### **3.4.1 Stacionimi**

Instrumenti stacionohet në pikat kontrolluese të verifikuara ose duhet të matet stacioni i lirë (matja brenda sipërfaqes në mënyrë që ti iket ekstrapolimit definicioni i EKSTRAPOLIMIT), për përshkrim më të hollësishëm rreth matjeve të pikave të poligonit dhe pikave kufitare shiqo Kornizat **2.5 për matjet e poligonit dhe të detalizuara**.

#### **3.4.2 Pikitimi i pikave eksistuese kufitare**

→ Piketo pika kufitare ekzistuese të parcelës në bazë të **Korniza 2005/05** Krahaso diferençat në shenja apo në monumentet ekzistuese në terren:

Shkalla e hartës 1:500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.15\text{m}$
Shkalla e hartës 1:1000:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.30\text{m}$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.60\text{m}$

Nëse arrihen të plotësohen kushtet, të dhënat e vektorizuara konsiderohen si valide.

Nëse diferençat janë jashtë tolerancës :

- Kërkohen matje shtesë për evitimin dhe zbulimin e gabimeve.

Parashtruesi i kërkeses/pronari duhet të jetë në vendin e ngjarjes për çfarëdo vendimi në lidhje me këtë rast, i cili me nënshkrim e aprovon studimin e bërë.

### **3.4.3 Piketimi i pikave të reja kufitare**

- Piketo kufijtë e parcelës së re, e cila është definuar më herët në zyre.
- Përshtatni pozitën e pikave në bazë të gjendjes reale (radhitja në kufinjë etj.)

Sinjalizimi i pikave të piketuara në bazë të nevojave me monumente perkatëse:

- Parcelat ekzistuese apo të reja
- Tipi i sinjalizimit: piketë, bulon, gurë etj.

Matja e pikave të reja kufitare nga stacioni tjetër në bazë të **Korniza 2005/05** dhe **Korniza 2005/06**

Kontrolli do te behet me këto mënyra :

- Matje e dyfishtë
- Stacion i lirë në të gjitha pikat kufitare të piketuara
- Matje me shirit

### **Definimi i kufinjëve në terren**

- Eksportoni dhe transferoni të gjitha koordinatat e kufijve të vlerësuar të parcelës dhe pikave kontrolluese në TCR303 **Korniza 2005/05**

#### **3.5.1 Stacionimi**

Instrumenti duhet të stacionohet në pikat kontrolluese të verifikuara ose duhet të matet stacioni i lirë (matja brenda sipërfaqes në mënyrë që t'i iket ekstrapolimit).

Për përshkrim të hollësishëm rrëth matjeve të poligonit dhe pikave të kufijve, shiqo **Korniza për te matjet poligoneve dhe pikave të detajit 2005/06**

#### **3.5.2 Piketimi i pikave eksiztuese kufitare (e njëjtë me 4.4.2 )**

- Piketo pika kufitare ekzistuese të parcelës së vlerësuar në bazë të **Korniza 2005/05**. Krahasoni diferençat në shenja apo në monumente ekzistuese në terren:

Shkalla e hartës 1:500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.15m$
Shkalla e hartës 1:1000:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.30m$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.60m$

Nëse plotësohen kushtet, të dhënrat e vektorizuara konsiderohen si valide.

Nëse paraqiten diferenca të mëdha, kërkohen matje shtesë për vlerësimin dhe gjetjen e gabimeve në të dhëna. Kërkuesi/pronari duhet të jetë në vendin e ngjarjes për çfarëdo vendimi në lidhje me këtë rast, me nënshkrim të pronarit verifikohet aprovimi i studimit.

### 3.5.3 Definimi i pikave të reja të kufijve

- Defino dhe shëno formën e re të parcelës në pajtim me pronarin.
- Përshtatni pozitën e pikave në bazë të gjendjes reale (radhitja në kufinjtë etj.)

Sinjalizimi i pikave të reja kufitare në bazë të nevojave me monumente përkatëse:

- Parcelat ekzistuese apo të reja
- Tipi i sinjalizimit: piketë, bulon, guri etj.

Matja e pikave të reja kufitare të definuara në bazë të **Korniza 2005/05** dhe **Korniza për matje te poligoneve dhe të detajit 2005/06**

## 3.6 Përpunimi i të dhënave dhe dokumentet e mutacionit (studimi)

Importimi i matjeve në GeosPro në bazë të **Korniza për matje te poligoneve dhe të detajit 2005/06** (Kapitulli 4.1). Llogaritja e koordinatave të pikave të reja dhe të korrigjuara kufitare në bazë të **Udhëzimeve për matje të poligonit dhe pikave të detajizuara 2.5** (Kapitulli 4) dhe të manualit të GeosPro (Tutorial, Online Help).

Hartoni dokumentet e mutacioneve në bazë të **Korniza 2005/15 mbi përdorimin e Softëare-it per mutacion GeosPro** dhe manualit të GeosPro (Tutorial, Online Help) dhe të shtojcave të rregulluara:

- Llogaritja e poligoneve (traversave )
- Llogaritja e pikave të kufijve
- Definimi i parcelave të reja

- Llogaritja e sipërfaqes për tërë parcelën e ndikuara (raporti i mutacionit)
- Harta e mutacionit në shkallë të përshtatshme


### 3.7 Eksportimi i të dhënave


Pasi që të pranohen të dhënat e vektorizuara të zonave kadastrale, të gjitha të dhënat brenda zonës kadastrave mund të eksportohen në ITF-fajll dhe të importohen në GeoWorkspace-in definitiv. Të gjitha të dhënat do të transformohen në sistemin KOSOVAREF01 pas një përshtatjeje lokale të kufinjëve të parcelave të ndikuara.

1. Bëni eksportimin nga GeoWorkspace-i me të dhënat e mutacionit në sistemin koordinativ FRYREF30
2. Importimi i fajllit **ITF** dhe barazimi lokal i të dhënat e vektorizuara
3. Transformimi i të dhënave nga FRYREF30 në KOSOVAREF01

Mirëmbajtja bëhet në bazë të kapitullit 4.

### 3.8 Diagrami





## 4. Mirëmbajtja nëse të dhënat e vektorizuara janë në dispozicion

### 4.1 Geoworkspace-i i cili shfrytëzohet

Udhëzuesit në bazë të këtij kapitulli përdoren vetëm atëherë kur të dhënat i kemi të vektorizuara dhe të transformuara në KOSOVAREF01. Ekziston vetëm një GeoWorkspace që përdoret për mirëmbajtjen e të gjitha mutacioneve pasuese.

### 4.2 Hapni projektin e ri të mutacionit

Hapni një projekt të ri të mutacionit për kërkesat e çfarëdo ndryshimi në të drejtat pronësore (p.sh. nëndarja e parcelës, shkrirja) në bazë të **Korniza mbi përdorimin e Softëare-it për mutacion GeosPro 2005/015**.

Për çdo mutacion të kërkuar formulari duhet të përdoret (shihni shtojcën 1) dhe duhet të caktohet numri unik i mutacionit. Forma e re e parcelës duhet të diskutohet fillimisht me kërkuesin dhe në pajtim me normat e planifikimit hapësinor.

### 4.3 Përgatitni informatat kadastrale të nevojshme

1. Ekzekutoni transformimin e të dhënavëve nga FRYREF30 në KOSOVAREF01

2. Kontrolloni kualitetin e të dhënavëve të vektorizuara:

→ Digjitalizoni 3 deri në 4 pikë kontrolluese. Sipërfaqja e mutacionit duhet të jetë e përcaktuar brenda këtyre pikave të digjitalizuara.

→ Krahasoni koordinatat e llogaritura me koordinatat e digjitalizuara:

Shkalla e hartës 1:500:	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pranohet nëse <math>\Delta &lt; 0.15\text{m}</math></li> </ul>
Shkalla e hartës 1:1000:	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pranohet nëse <math>\Delta &lt; 0.30\text{m}</math></li> </ul>
Shkalla e hartës 1:2500:	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pranohet nëse <math>\Delta &lt; 0.60\text{m}</math></li> </ul>

- Kontrolloni vektorizimin nëse diferençat janë më të mëdha:
- Llogaritni koordinatat e disa pikave kufitare të bazuara në matjet ekzistuese
  - Krahasoni me të dhënat e vektorizuara
  - Zëvendësoni definimin e kufinjëve me të dhënat e llogaritura.
  - Nëse diferençat janë shumë të mëdha, mutacionet e mëparshme duhet të kryhen përfundimisht

#### 4.4 Definimi i kufinjëve në hartat kadastrale (mutacioni në zyre)

Forma e re e parcelës duhet të diskutohet dhe definohet përfundimisht me pronarin.

- Llogaritni pikat kufitare të definimit të ri të parcelës në GeosPro në bazë të manualit të GeosPro (Tutorial, Online Help) **me përdorimin e ProCalc / Pikat e ndërprerjes.**
- Eksportoni dhe transferoni të gjitha koordinatat e kufinjëve të ndikuar të parcelës dhe pikat kontrolluese në TCR303 **Korniza2005/05.**

##### 4.4.1 Stacionimi

Instrumenti duhet të stacionohet në pikat kontrolluese të verifikuara ose duhet të matet stacioni i lirë (matja brenda sipërfaqes në mënyrë që t'i iket ekstrapolimit). Për përshkrim më të hollësishëm rreth matjeve të poligoneve (traversave) dhe pikave të kufinjëve, shihni **Korniza 2005/06**

##### 4.4.2 Piketimi i pikave eksiztuese kufitare

→ Piketo pika kufitare ekzistuese të parcelës në bazë të **Korniza 2005/05.** Krahasoni ndryshimet në shenja apo në monumentet ekzistuese në terren:

Shkalla e hartës 1:500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.15\text{m}$
Shkalla e hartës 1:1000:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.30\text{m}$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.60\text{m}$

Nëse plotësohen kushtet, të dhënat e vektorizuara merren si valide.

Nëse paraqiten ndryshime të mëdha, kërkohen matje shtesë përvlerësimin dhe korrigjimin e gabimeve në të dhëna. Parashtruesi i kërkeshës/pronari duhet të jetë në vendin e ngjarjes përfarëdo vendimi në lidhje me këtë rast.

#### 4.4.3 Piketimi i pikave të reja kufitare

→ Piketoni pikat e kufijve të parcelës së re, të definuar më herët në zyre.

→ Përshtat pozitën e pikave në bazë të gjendjes reale (radhitja në kufinjë etj.)

Sinjalizimi i piketimeve në bazë të nevojave me monumente.

- Parcelat ekzistuese apo të reja
- Tipi i sinjalizimit: piketë, bulon, guri etj.

*Matja e pikave të reja të kufijve nga stacioni tjetër të definuara sipas Korniza 2005/05 dhe Korniza 2005/06*

Kontrollet e obligueshme:

- Matje e dyfishtë
- Stacion i lirë në të gjitha pikat e piketuara të kufijve (së paku një nga këto pika)
- Matjet me metërshirit

Definimi i kufinjëve dhe matjet në terren. Eksporto dhe transfero të gjitha koordinatat të kufijve të ndikuara të parcelës dhe pikave kontrolluese në TCR303 **Korniza 2005/05**

#### 4.4.4 Stacionimi

**4.5 Instrumenti duhet të stacionohet në pikat kontrolluese të verifikuara ose duhet të matet stacioni i lirë (matja brenda sipërfaqes në mënyrë që t'i iket ekstrapolimit).**

Për përshkrim më të hollësishëm rreth matjeve të poligoneve dhe pikave kufitare, shiko **Korniza 2005/06** Piketimi i pikave eksistuese të kufijve

→ Piketo pika kufitare ekzistuese të parcelës së vepruar në bazë të **Korniza 2005/05** Krahasoni ndryshimet në shenja apo në monumentet ekzistuese në terren:

Shkalla e hartës 1:500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.15m$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.30m$
Shkalla e hartës 1:2500:	▪ Pranohet nëse $\Delta < 0.60m$

Nëse plotësohen kushtet, të dhënave e vektorizuara konsiderohen si valide.

Nëse paraqiten ndryshime të mëdha, kërkohen matje shtesë për evitimin dhe deshifrimin e gabimeve në të dhënrat. Kërkuesi/pronari duhet të jetë në vendndodhje për çfarëdo vendimi në lidhje me rastin, me nënshkrim pronari e aprovon studimin.

#### **4.5.1 Definimi i pikave të reja kufitare**

Definoni dhe shënoni formën e re të parcelës në pajtim me pronarin.

Përshtatni pozitën e pikave në bazë të gjendjes reale (radhitja në kufinjë etj.)

Sinjalizimi i piketimeve në bazë të nevojave dhe kërkesave të pronarit:

- Parcelat ekzistuese apo të reja
- Tipi i sinjalizimit: piketë, bulon, guri etj.

Matja e pikave të reja kufitare të definuara në bazë të **Korniza 2005/05** dhe **Korniza 2005/06**


### **4.6 Përpunimi i të dhënave dhe dokumentet e mutacionit (studim)**


Importimi i matjeve në GeosPro në bazë të **Korniza 2005/06** për matje të poligoneve dhe pikave te detajit (**Kapitulli 4.1**). Llogaritja e koordinatave të pikave të reja dhe të korigjuara të kufijve sipas **Korniza 2005/06** për matje të poligoneve dhe pikave te detajit (**Kapitulli 4**) dhe doracakut të GeosPro (Tutorial, Online Help).

Hartoni dokumentin e mutacioneve në bazë të **Korniza 2005/15 mbi përdorimin e Softëare-it për Mutacion GeosPro** dhe manualit të GeosPro (Tutorial, Online Help) dhe të shtojcave të rregulluara:

- Llogaritja e traversave
- Llogaritja e pikave kufitare
- Definimi i parcelave të reja
- Llogaritja e sipërfaqes për të gjitha parcelat që e kufizojnë parcelën në mutacion (Raporti mbi Mutacion)
- Harta e mutacionit në shkallën e duhur

## 4.7 Diagrami





## 5. Verifikimi i të dhënave

Studimi i përcaktimit të kufinjve duhet të miratohet dhe nënshkruhet nga personi përgjeqjës (udhëheqësi i departamentit të gjeodezisë ose nga gjeodeti privat i licencuar).

## 6. Shtojcat

### 6.1 Formulari i Mutacioneve (Lista kontrolluese)

1

#### Kosovo Cadastral Agency Maintenance Guidelines

Municipality.....	Cadastral Plan.....	Mut.Nr.....
-------------------	---------------------	-------------

#### Checklist

##### A Request

		Date:	Sig.
Office1	<input type="checkbox"/> Legal Clarifications <input type="checkbox"/> Open Job in Mutationregister <input type="checkbox"/> Reserve <b>new parcel number</b> <input type="checkbox"/> Calculate project and boundary points <input type="checkbox"/> Line definitions / Area calculations <input type="checkbox"/> Stake out elements <input type="checkbox"/> Printing coordinate register		
Field	<input type="checkbox"/> Stake out / Measurement <input type="checkbox"/> Register of measurements <input type="checkbox"/> Check of Monuments <input type="checkbox"/> Not built Monuments	Number:	Built:
Office2	<input type="checkbox"/> Calculation CP3 <input type="checkbox"/> Coordinate Register CP3 <input type="checkbox"/> Calculation / Control calculation Boundary Points <input type="checkbox"/> Coordinate Register Boundary Points <input type="checkbox"/> Construction / Line definition in Geos Pro <input type="checkbox"/> Check area differences <input type="checkbox"/> Control Plot	Plan Nr: Plan Nr: Plan Nr:	S1: S1: S1:
	<input type="checkbox"/> Mutation plan (3 Copies) <input type="checkbox"/> Cover letter (3 Copies) <input type="checkbox"/> Networkplan CP3 <input type="checkbox"/> Parcel register (Areas) <input type="checkbox"/> Data Base (KCID) <input type="checkbox"/> Surface Ceiling <input type="checkbox"/> Parcel control <input type="checkbox"/> Complete Mutations		

##### B legal approval

<input type="checkbox"/> Legal validation in GeosPro <input type="checkbox"/> Topology check <input type="checkbox"/> Area calculations table <input type="checkbox"/> Plot of definitive plan <input type="checkbox"/> Parcel register (Areas) <input type="checkbox"/> Data Base (KCID) <input type="checkbox"/> Definitive Mutation register	

Sig. MCO Director:

## 6.2 Llogaritja e poligoneve dhe përshtatja e rrjetit

Shiko udhëzimin 2.5 për matje të poligoneve dhe matje të detajuara.

### Orientimi

ADV-mode Toleranca 3 Faktori i tolerancës 1.000  
 K-Éert 0.130 Me zbrtje në projektim Me zbrtje në nivel të detit  
 Stacioni:

Nr	NC	CI	Y	X
30003	11	0	7494279.059	4723884.662

STACIONI: 30003

### Pikat të cakut

Nr	NC	CI	Y	X	Az	R	O	dO	D cal	D red	dD	dH
30010	11	0	7494226.914	4723692.946	195.12570	0.00540	195.12030	0.00000	198.681	198.704	0.02	-0.051
Pika e cakut	30011	Pika lidhëse e pa njohur										

Orientimi mesatar: 195.12030

### Orientimi

ADV-mode Toleranca 3 Faktori i tolerancës 1.000  
 K-Éert 0.130 Me zbrtje në projektim Me zbrtje në nivel të detit  
 Stacioni:

Nr	NC	CI	Y	X
30004	11	0	7493854.528	4723414.584

STACIONI:

30004

### Pikat e cakut

Nr	NC	CI	Y	X	Az	R	O	dO	D cal	D red	dD	dH
30010	11	0	7494226.914	4723692.946	53.13176	267.44053	145.29123	0.00000	464.927	464.989	0.062	-0.057
Pika e cakut	30012	Pika lidhëse e panjohur										
Pika e cakut	30013	Pika lidhëse e panjohur										

Orientimi mesatar: 145.29123

### LLOGARITJA E PIKAVE FIKSE Poligoni i lidhur TR01

ADV-mode Toleranca 3 Faktori i tolerancës 1.000  
 K-Vert 0.130 Me zbrtje në projektim Me zbrtje në nivel të detit

### VLERAT E HYRA

Stacioni	Pika e cakut	dukja 1	dukja 2	Dir	dF	def	meas	D red	Heightm.	I	S	dH
30003	30011	67.00543	0.00000	67.00543	91.290	91.282	89.46286	1.530	1.800	0.090	0.005	
		0.00000	0.00000			-0.002						
30011	30003	69.55455	0.00000	69.55455	91.292	91.283	89.42519	1.460	2.000	-0.084		
30011	30012	214.53544	0.00000	214.53544	153.905	153.892	90.01308	1.460	2.000	-0.606		
		0.00000	0.00000			0.003						-0.018
30012	30011	235.38471	0.00000	235.38471	153.907	153.889	89.32502	1.370	2.000	0.588		
30012	30004	40.30574	0.00000	40.30574	416.839	416.770	90.44101	1.370	2.000	-5.974		
		0.00000	0.00000			0.003						0.014
30004	30012	246.34207	0.00000	246.34207	416.846	416.766	89.09487	1.390	1.500	5.987		

### LLOGARITJA E PIKAVE FIKSE POLIGONI I LIDHUR TR01

ADV-mode Toleranca 3 Faktori i tolerancës 1.000  
 K-Éert 0.130 Me zbrtje në projektim Me zbrtje në nivel të detit

Numri A: Sum S:	4 661	Fé: Toleranca: % der Tol.:	0.00164 0.03144 8	dY: dX:	0.013 0.084	Fs: Toleranca: % der Tol.:	0.085 0.615 13	Fh: Toleranca: % der Tol.:	0.008 0.403 2
Numri	NC	CI	Angel	Azimut	D red	Y-Coord.	X-Coord.	DHHeight	Orient
30003	11	0	67.00543	262.13014	91.282	7494279.059	4723884.662	620.828	195.12030
30011	15	2	144.58089	227.11144	153.891	7494188.619	4723872.312	620.916	12.17388
30012	15	2	164.52103	212.03288	416.768	7494075.731	4723767.747	620.321	171.32429
30004	11	0	246.34207			7493854.528	4723414.584	614.346	145.29123

## 6.3 Llogaritja e pikave kufitare

Shiko udhëzimin 2.5 për matje të poligoneve dhe detale.

AKK Prishtinë  
Ndërtesa e Arkivit  
Kosovë

Njësia për matje/GIS  
Dobrashevc

Verzioni 1.10 03/10/2005

17

Numri	Veprimi	-Kodi	Cl	Y	X	H	Fs/dO	dh	
<b>30012Stacioni i ri 15</b>		<b>2</b>		<b>7494075.731</b>	<b>4723767.747</b>		<b>620.321</b>	<b>-0.00013</b>	<b>171.32426</b>
22 Mesatare		1 3		7494082.309	4723717.816		0.000	0.069	0.000
21 Mesatare		5 3		7494088.251	4723723.168		0.000	0.010	0.000
48 Hyrje e re		5 5		7494112.286	4723741.453		0.000		
49 Hyrje e re		5 5		7494128.288	4723754.884		0.000		
47 Mesatare		5 3		7494133.260	4723779.154		0.000	0.049	0.000
31 Mesatare		1 3		7494128.550	4723787.997		0.000	0.035	0.000
32 Mesatare		1 3		7494091.244	4723856.102		0.000	0.058	0.000
29 Mesatare		1 3		7494073.898	4723841.486		0.000	0.024	0.000
28 Mesatare		1 3		7494060.784	4723828.288		0.000	0.017	0.000
27 Mesatare		1 3		7494067.289	4723801.972		0.000	0.018	0.000
26 Mesatare		1 3		7494072.139	4723782.132		0.000	0.023	0.000
50 Hyrje e re		5 5		7494044.525	4723818.661		0.000		
51 Hyrje e re		5 5		7494016.421	4723793.136		0.000		
52 Hyrje e re		5 5		7494003.265	4723777.097		0.000		
53 Hyrje e re		1 5		7493973.767	4723730.769		0.000		
54 Hyrje e re		1 5		7493962.192	4723708.156		0.000		
55 Hyrje e re		1 5		7493952.233	4723681.520		0.000		
56 Hyrje e re		5 5		7493939.154	4723638.784		0.000		
57 Hyrje e re		5 5		7493952.888	4723629.404		0.000		
58 Hyrje e re		1 5		7493990.546	4723666.192		0.000		
59 Hyrje e re		1 5		7494004.570	4723680.887		0.000		
60 Hyrje e re		1 5		7493996.824	4723712.753		0.000		
61 Hyrje e re		1 5		7494029.400	4723704.366		0.000		
62 Hyrje e re		1 5		7494051.185	4723723.583		0.000		
63 Mesatare		1 3		7494046.762	4723694.709		0.000	0.022	0.000
64 Hyrje e re		1 5		7494001.609	4723626.876		0.000		
65 Hyrje e re		1 5		7493986.716	4723608.555		0.000		
66 Hyrje e re		1 5		7493961.977	4723575.380		0.000		
67 Hyrje e re		5 5		7494016.268	4723548.561		0.000		
68 Mesatare		1 3		7494024.860	4723580.070		0.000	0.066	0.000
69 Hyrje e re		1 5		7494039.931	4723635.031		0.000		

## 6.4 Regjistrimi i pikave

AKK Prishtinë  
Ndërtesa e Arkivit

Njësia për matje/GIS  
Dobrashevci

Verzioni 1.10

03/10/2005

18

### REGJISTRI I PIKAVE

Numri	NC	Cl	Y-Coord	X-Coord	Lartësia	Nr Mutacionit
21	5	3	7494088.251	4723723.168	0.000	1
22	1	3	7494082.309	4723717.816	0.000	1
23	5	5	7494104.858	4723735.661	0.000	1
24	1	5	7494106.079	4723755.488	0.000	1
25	1	5	7494079.862	4723744.158	0.000	1
26	1	3	7494072.139	4723782.132	0.000	1
27	1	3	7494067.289	4723801.972	0.000	1
28	1	3	7494060.784	4723828.288	0.000	1
29	1	3	7494073.898	4723841.486	0.000	1
30	1	5	7494086.700	4723808.744	0.000	1
31	1	3	7494128.550	4723787.997	0.000	1
32	1	3	7494091.244	4723856.102	0.000	1
33	5	5	7494091.534	4723863.431	0.000	1
34	1	5	7494159.485	4723832.049	0.000	1
35	5	5	7494183.877	4723820.482	0.000	1
36	5	5	7494192.258	4723846.460	0.000	1
37	5	5	7494216.711	4723838.361	0.000	1
38	1	5	7494200.833	4723874.972	0.000	1
39	1	5	7494208.609	4723903.378	0.000	1
40	1	5	7494215.980	4723933.320	0.000	1
41	1	5	7494161.842	4723948.606	0.000	1
42	1	5	7494140.927	4723919.503	0.000	1
43	1	5	7494121.933	4723897.555	0.000	1
44	1	5	7494106.417	4723880.244	0.000	1
45	1	5	7494180.481	4723793.991	0.000	1
46	1	5	7494163.182	4723793.047	0.000	1
47	5	3	7494133.260	4723779.154	0.000	1
48	5	5	7494112.286	4723741.453	0.000	1
49	5	5	7494128.288	4723754.884	0.000	1
50	5	5	7494044.525	4723818.661	0.000	1
51	5	5	7494016.421	4723793.136	0.000	1
52	5	5	7494003.265	4723777.097	0.000	1
53	1	5	7493973.767	4723730.769	0.000	1
54	1	5	7493962.192	4723708.156	0.000	1
55	1	5	7493952.233	4723681.520	0.000	1
56	5	5	7493939.154	4723638.784	0.000	1
57	5	5	7493952.888	4723629.404	0.000	1
58	1	5	7493990.546	4723666.192	0.000	1
59	1	5	7494004.570	4723680.887	0.000	1
60	1	5	7493996.824	4723712.753	0.000	1
61	1	5	7494029.400	4723704.366	0.000	1
62	1	5	7494051.185	4723723.583	0.000	1
63	1	3	7494046.762	4723694.709	0.000	1
64	1	5	7494001.609	4723626.876	0.000	1
65	1	5	7493986.716	4723608.555	0.000	1
66	1	5	7493961.977	4723575.380	0.000	1
67	5	5	7494016.268	4723548.561	0.000	1
68	1	3	7494024.860	4723580.070	0.000	1
69	1	5	7494039.931	4723635.031	0.000	1
70	1	5	7494050.480	4723688.660	0.000	1

## 6.5 Llogaritjet e sipërfaqeve të të gjitha parcelave të dëmtuara

### REGJISTRI I SIPERFAQEVE TE NDERRUARA

NB-Ident	Nr.i pjeses	Definimi i ri Siperfaqja	Siperfaqja e ngastres sip.per.	Mutacioni 1111		
				Emri	Definimi i vjetër Siperfaqja e pjeses	Te mbledhura
70309093-2621-0	10197.7294	10198	70309093-2621-0	10197.7294	10198	0.2706
			TOTALI:	10197.7294	10198	0.2706
70309093-131-1	406.4992	406	70309093-131-0	406.4992	406	-0.4992
			TOTALI:	406.4992	406	-0.4992
70309093-131-2	400.8699	401	70309093-131-0	400.8699	401	0.1301
			TOTALI:	400.8699	401	0.1301
70309093-131-3	401.7357	402	70309093-131-0	401.7357	402	0.2643
			TOTALI:	401.7357	402	0.2643
70309093-131-4	394.8619	395	70309093-131-0	394.8619	395	0.1381
			TOTALI:	394.8619	395	0.1381
70309093-131-5	185.7920	186	70309093-131-0	185.7920	186	0.2080
			TOTALI:	185.7920	186	0.2080

### REGJISTRI I SIPERFAQEVE TË NDËRRUARA

NB-Ident	nr.i ngastres	Definimi i vjetër Siperfaqja	Siperfaqja e pjeses sip. per.	Mutacioni 1111		
				Emri	Definimi i ri Siperfaqja e pjeses	Te mbledhura
70309093-2621-0	10197.7294	1	70309093-2621-0	10197.7294	10198	
			TOTALI:	10197.7294	10198	
70309093-131-0	1789.7586	1	70309093-131-5 70309093-131-4 70309093-131-3 70309093-131-2 70309093-131-1	185.7920 394.8619 401.7357 400.8699 406.4992	186 395 402 401 406	
			TOTALI:	1789.7586	1790	

Agjencionari Kadastral i Kosovës  
 Drejtori i Matjes /GIS  
 Nr i Mutationit.: GEOS Pro 2.0

DGJKP Pejë  
 Zona Kadastrale Vitomiricë  
 27.7.2004 Fleta 8

### Tabela e Mutationit

Siperfaqet e pjeseshme te pakompenzuera  
 Permbledhja e diferencave te caktuera nuk printohet

	Nr.i vjeter i ngastres		
	70309093-2621-0	70309093-131-0	
Nr. i ri i parceles			Totali
70309093-2621-0	10198		10198
70309093-131-1		406	406
703809093-131-2		401	401
70309093-131-3		402	402
70309093-131-4		395	395
70309093-131-5		186	186
Totali i parcelave te vjetra	10198*	1790*	11988


Numri i planit : .....

Regjistrimi ne RDPP : .....

Shenimet:

Vendi/Data: ..... Mbikqyresi i licencuar: .....

## 6.6 Harta e mutacioneve në përpjjesën e duhur



Prishtinë 31.03.2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV  
Prof. Dr. sc Murat Meha



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS  
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA  
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## **KORNIZA**

**Nr. AKK 2005/04**

### **RRJETI REFERENT I RENDIT TË III-të DHE LOKAL**

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke u bazuar në Nenin 34.2 të Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor 2003 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/04 dhe Nenit 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/08 për Zbatimin e Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25, me 20.05.2005 aprovon këtë Kornizë si vijon:

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>65</b>
<b>2. PLANIFIKIMI.....</b>	<b>65</b>
2.1 TË DHËNAT E OFRUARA NGA AKK-JA.....	65
2.2 PLANIFIKIMI I RRJETIT NË ZYRE.....	65
2.2.1 Sipërfaqet prioritare.....	65
2.2.2 Kriteret për planifikimin e rrjetit:.....	66
2.3 GJURMIMI NË TERREN.....	66
2.3.1 Forma definitive e rrjetit .....	66
<b>3. VENDOSJA E MONUMENTEVE TË RRJETIT .....</b>	<b>67</b>
3.1 GJURMIM .....	67
3.2 STABILIZIMI .....	67
Monumentet në sipërfaqe (të lavruara, livadhe, dhe të pa kultivuara) .....	67
<b>4. FUSHATA E MATJEVE.....</b>	<b>69</b>
<b>5. NUMËRIMI I PIKAVE.....</b>	<b>71</b>
<b>6. PËRSHKRIMI I POZICIONIT (INVENTARIT) TE PIKAVE.....</b>	<b>72</b>
<b>7. INTEGRIMI I RRJETEVE TJERA LOKALE.....</b>	<b>72</b>
<b>8. PËRPUNIMI .....</b>	<b>73</b>
8.1 PARIMET E RREGULLIMIT ME GEOSPRO PROCALC.....	73
8.2 RREGULLIMI NË GEOSPRO .....	74
8.3 VLERËSIMI I RAPORTEVE DHE REZULTATEVE TË RREGULLIMIT .....	76
8.4 RAPORTI DHE DOKUMENTIMI .....	78
<b>9. MIRËMBAJTJA E RRJETIT REFERENT TË RENDIT TË III-TË.....</b>	<b>78</b>
9.1 NJOFTIMI DHE ORGANIZIMI.....	78
SHTOJCA 1 .....	80
SHTOJCA 2 .....	81
SHTOJCA 3 .....	82

## 1. Hyrje

Këto Korniza do të jenë përshkrim i detajuar i procedurave për themelimin e rrjetit referent të rendit të III-të dhe rrjetit lokal. Kornizat janë ndërtuar në përputhje me *Kornizat Teknike për shërbimet Kadastrale* (Dokumenti 060-001), *të planit të punës për rrjetin referent të rendit të III-të* (Dokumenti 020-009/010, SGU 2001), (Dokumenti 070-004), si dhe Ciceronit për Geos Pro (*USER's Guide for GeosPro*)

Kornizat duhet të kuptohen si rregulla të përgjithshme pasi që secila situatë për secilën rrjetë lokale duhet të vlerësohet veqanërisht. Kornizat aplikohen vetëm nëse ZKK-ja ka njoftuar një plan-projekt paraprak të konfirmuar dhe aprovuar nga AKK-ja.

## 2. Planifikimi

Planifikimi përfshinë përgatitjet duke filluar nga organizimi, orari, plani për personelin, mjetet dhe materialin për ndërtimin e monumenteve dhe kryerjes së fushatës së matjeve (shih Planin e Punës për rrjetin referent të rendit të III-të).

### 2.1 Të dhënat e ofruara nga AKK-ja

AKK-ja dorëzon hartat topografike me shkallë 1:25 000, kopjet e forta të ortofotove ose hartat kadastrale për sipërfaqen e përcaktuar. Këto harta kanë pikat ekzistuese të rendit të I-rë dhe të II-të.

### 2.2 Planifikimi i Rrjetit në Zyre

Planifikimi i rrjetit bazohet në formën (gjeometrin e pikave) dhe sipërfaqet prioritare (shih planin e punës për rrjetin e rendit të III-të). Identifikoohen sipërfaqet ku ka nevojë për matje me GPS RTK, shënohen vendqëndrimet e mundshme të pikave të reja (që do të maten me Stacion-Total apo GPS).

#### 2.2.1 Sipërfaqet prioritare

Gjatë fazës së planifikimit të rrjetit territori i komunës do të ndahet në tri pjesë, sipas prioriteteve dhe varësisht nga veprimtaritë qe zhvillohen atje.

Prioriteti 1: Qendra e qytetit dhe sipërfaqet urbane - 50 deri në 80 pika në km<sup>2</sup>

Prioriteti 2: Fshatrat që janë të vendosura në terrene të rrafshëta 20 deri në 30 pika në  $\text{km}^2$

Prioriteti 3: Sipërfaqet ku ka pak veprimitari matëse -10 pika në  $\text{km}^2$ .

## 2.2.2 Kriteret për planifikimin e rrjetit:

### Analizohen sipërfaqet prioritare

Pikat duhet të mbulojnë territorin ku priten shumë veprimitari matëse, sidomos në sipërfaqet e planifikuara për:

banim, ndërtim të sistemeve të reja bujqësore, komasacion të tokës, qartësim të kufijve të parcelave, etj.

Zgjedhja e pikave duhet të përfshijë mundësisht sa më shumë pika ekzistuese (trigonometra, pika poligionale dhe pika lidhëse )

## 2.3 Gjurmimi në terren

Gjurmimi në terren përfshin atë se: a janë plotësuar te gjitha kërkesat (dukshmëria, sipërfaqet stabile, mundësia e sinjalizimit të qëndrueshëm, GPS, etj.). Hapat për gjurmimin dhe themelimin e pikave janë shpjeguar në kapitullin 3.

### 2.3.1 Forma definitive e rrjetit

Vizatoni formën e rrjetit në harta. Lidhni pikat me vija dhe shënoni aty ku janë matur vetëm këndet, distancat apo të dyja, ndërmjet pikave fqinje (shih shtojcën 2). Vlersone stabilitetin e rrjetit, se: a është siguruar lidhja me pikat e rendit të dytë dhe asnjë pikë nuk është jashtë përcaktimit? Eventualisht duhet të shtohen pikë të reja.

Planifikimi dhe formësimi i rrjetit i propozuar nga ZKK-të duhet të miratohet nga ekspertët e AKK-së, respektivisht nga Drejtorati i Matjes para fillimit të matjeve.

### 3. Vendosja e monumenteve të rrjetit

#### 3.1 Gjurmimi

Vizatohet rrjeti paraprak ekzistues, pastaj duhet qe për të gjitha pikat e reja të analizohet vendi i tyre dhe të verifikohen kriteret në terren si në vijim.


- Mënyra e stabilizimit
- Sinjalizimi i qëndrueshëm dhe stabil
- Garantimi i lidhjes dhe rregullimit me pikat më të afërta të rendit të I-rë dhe II-të
- Dukshmëria ndaj pikave tjera të rendit të III-të
- Përshtatshmëria për matje me pajisje GPS
- Qasje me veturë (pikat mundësisht afër rrugëve)

#### 3.2 Stabilizimi

Mënyra e stabilizimit të pikave varet nga cilësia e sipërfaqes ku është menduar të vendoset pika, toka të lërueshme, tokë e pa kultivuar, gurë, beton, asfalt, etj.


#### Monumentet në sipërfaqe (të lavruara, livadhe, dhe të pa kultivuara)

- Gypa plastik me beton (0.50 m gjatësi,  $\phi = 70$  mm) me bulon metalik në qendër.




*Ndërtimi i Monumenteve*

1. Gërmohet gropë sa më e ngushtë (më pak se 40cm  $\phi$ )
2. Mbulohet shtresa e poshtme me rërë deri në 5cm
3. Vendoset monumenti në pozitë vertikale me gyp nivinizues
4. Mbushet me shtresë betoni prej 20 cm (nëse ka mundësi, nëse jo përdorni gurë)
5. Bllokohet monumenti me shtresë tjeter gurësh
6. Pjesa tjeter mund të mbushet me gurë të vegjël dhe
7. Maja e monumentit do të jetë më pak se 5 cm mbi tokë



**Monumentet në asfalt, beton, etj:**

- Bulon çeliku në formë gozhde si ne figurën në vijim



*Ndërtimi i monumenteve*

Përdoret makina e shpuarjes për të vendosur bulonin në sipërfaqe betoni apo asfalti.  
Gropa mbushet me beton.

## 4. Fushata e Matjeve

Matjet ne rrjetin referent të rendit të III-të bëhen në dy mënyra:

- a) TPS (pozicionimi i Stacionit -Total) do të aplikohet kryesisht nga personeli lokal.
- b) GPS (RTK - Real Time Kinematik) përdoret në sipërfaqe ku dukshmëria është penguar ose rrjeti referent i rendit të II-të nuk është i dendur. Aparatet (pajisjet) GPS dhe eksperti mbikëqyrës nga AKK-ja mund të përdoren vetëm me kërkesë nga ZKK-ja . Kërkesat duhet të bëhen së paku 15 dite para shfrytëzimit të kërkuar.

Me qëllim të arritjes së rezultateve në kuptim të saktësisë, sigurisë dhe cilësisë, fushata e matjeve duhet t'i plotësoj kushtet ne vijim :

TPS (total station):

Matjet	Sipas rrjetit të dizajnuar Këndet në dy faqe për secilën pikë të dukshme (1 tërësi) Reduktimi i distancave për shkak të ndikimit atmosferik
Shënimet	Krijimi dhe përdorimi i Formularëve "Libri i Terrenit" Vizatimi i skicës së secilës pikë stacionare
Personeli i kërkuar:	1 Ekspert matjesh dhe 1 ndihmës

Matjet GPS-RTK:

Stacionet referente:	1
Kontroll:	Observohen koordinatat e pikës të njohur të rendit të I-rë ose II-të për kontrollimin e stacionit referuese
Seancat dhe pavarësia:	2 Seanca në kohë të ndryshme (mëngjes dhe pasdite)
Personeli i kërkuar:	1 ekip me resiverë SR530 dhe AT502 antena (1 reference, 1 rover). Mbikëqyrja nga Eksperti i AKK-së

## 5. Numërimi i pikave

Numri i pikës gjithmonë përbëhet nga 6 shifra ku dy shifrat e para janë kodi i komunës gjegjëse (shih kodet e komunave ne vijim) duke e pasuar nga numri rendor që fillon me një (0001).

Sintaksa:

**XXYYYY**

- **XX**   është numri i komunës
- **YYYY**  është numri rendor

Shembull:     190001, 250020, 010589 etj.

Numrat 19,20,01 janë kodi i komunës

0001,0025,0589 janë numra pikash

### Kodet e Komunave

Nr.	Komuna	Kodi	Nr.	Komuna	Kodi
1	Viti	01	16	Pejë	16
2	Vushtrri	02	17	Podujevë	17
3	Gjilovc	03	18	Prizren	18
4	Gjilan	04	19	Prishtinë	19
5	Deçan	05	20	Skenderaj	20
6	Dragash	06	21	Suharekë	21
7	Gjakovë	07	22	Ferizaj	22
8	Istog	08	23	Malishevë	23
9	Kaçanik	09	24	Novo Bërdë	24
10	Klinë	10	25	Fushë Kosovë	25
11	Kamenicë	11	26	Obiliq	26
12	Mitrovicë	12	27	Shtërpce	27

13	Leposaviq	13	28	Shtime	28
14	Lipjan	14	29	Zubin Potok	29
15	Rahovec	15	30	Zveçan	30

Për udhëzime të mëtejshme shih **Korniza nr 2005/05**

## 6. Përshkrimi i Pozicionit (Inventarit) te Pikave

Krijimi i dokumentacionit të pikave gjatë identifikimit apo stabilizimit te tyre ne terren behet si ne vijim. Si shembull shih formën në shtojcën 1.

1. Fotografimi i vend-qëndrimit të pikës me kamerë digjitale
2. Përshkruhet vendndodhja e pikës në librin e terrenit
3. Regjistrohen informacionet mbi pikën gjatë fushatës së matjeve
4. Skica grafike (shkallë e përafërt) e situatës me masa kontrolli për pika të identifikueshme. Skicat përfshijnë ndërtesat, rrugët, kufirin e parcelave, eventualisht emrin e pronarëve, pemët, shtyllat elektrike, etj.

## 7. Integrimi i rrjeteve tjera lokale

Rrjetet lokale ekzistuese apo te krijuara nga te tjeret si psh nga (KFOR) janë shumë të vlefshme dhe duhet të integrohen, transformohen dhe eventualisht të rregullohen brenda sistemit Kosovaref01. shfrytëzimi i tyre i nenshtroet procedurës ne vazhdim.

1. Çfarë dokumentacioni ka për ato pikat (matje, dokumentim, raporte teknike, inventar pikash, etj.)?
2. A ka koordinata të shfrytëzueshme dhe në cilin sistem?
3. A është rregulluar rrjeti i mëparshëm?
4. A ka pikat të përbashkëta të matura në dy sistemet?
5. Eventualisht bëni matjet për pikat në sistemin lokal në koordinatat e KOSOVAREF01
6. Transformoni koordinatat e rregulluara me pikat veçuese Transformimi i Helmertit me gabime të përafërtë.
7. Dokumentimi i llogaritjeve dhe inventari i pikave

## 8. Përpunimi

### 8.1 Parimet e Rregullimit me GeosPro ProCalc

Vrojtimet në rrjet janë gjithmonë të ngarkuara me gabime të vogla dhe sistematike. Është ide themelore e rregullimit që të përcaktohen korrigjimet e vogla për secilin vrojtim me qëllim të shmangjes së ndikimit të tyre në rezultat si:

- Largimi i pengesave gjatë vrojtimeve – rregullimi për përpunim
- Madhësia e korrigjimeve lejon vlerësimin e saktësisë dhe sigurinë e matjeve
- Rregullimi anulon pengesat dhe rritë saktësinë. Vrojtimet e rregulluara janë bërë në matjet origjinale.

Me softuerin **ProCalc** barazimi bëhet me metodën e katrorëve minimum ( $[\nabla\nabla]=\min$ ) sipas Gauss-it.


Parimisht ekzistojnë tri lloje barazimesh te matjeve ne rrjete:

- Rregullimi dhe barazimi vetëm me matje tokësore (matjet e drejtimit dhe distancës, dallimi në lartësi)
- Rregullimi dhe barazimi vetëm me matje GPS (tërësitë e koordinatave të seancave matëse)
- Rregullime dhe barazime të matjeve të kombinuara me GPS dhe matje tokësore

**Koordinatat e përaferta** të pikave të reja duhet të përpunoohen para rregullimit në GeosPro ProCalc. Më tej, parametrat e reduktimit dhe definimet e instrumentit duhet të bëhen në mënyrë korrekte (shih **Korniza nr 2005/14**).

Llogaritja e vlerave të përaferta mund të bëhet me llogaritje të poligonet (shih **Korniza nr 2005/06**)

Është e rëndësishme që pikat të kenë kodet e rregullta natyrore në përputhje me matjet e regjistruara, në mënyrë që të shhangim hutinë gjatë llogaritjeve.




Shembull i një rrjeti të rendit të III-të me matje të kombinuara GPS dhe tokësore

GL01

GL11

## 8.2 Rregullimi në GeosPro

Së pari duhet të bëhet definimi i rrjetit në kategorin e dialogut "rregullimi i rrjetit" (network adjustment). Secili definim mund të ruhet për tu përdorur për llogaritje të mëvonshme.



Nga praktika rekomandohet që për barazimin e rrjetit të përdorën 4 variante të ndryshme të llogaritjes:

**Pseudo rregullimi** – Kjo llogaritje bëhet për të gjetur gabimet e mëdha (koordinata të gabueshme, gabimet në numrin e pikave) në të dhënat e matjeve etj. Gjendja e matjeve mbetet e pandryshuar (nuk azhurnohet në bazë të të dhënave).

**Rregullimi i lirë** – (pa shtrëngim të pikave të kontrollit) përdoret për të vlerësuar treguesit e sigurisë të matjeve të ndryshme.

Shtrëngimi minimal i rrjetit është i mundshëm në dy mënyra:

- Dy pika rrjeti dhe një faktor shkalle në matjet e distancës
- Me rrjetë të pastër GPS ekziston mundësia e ruajtjes së vetëm një pike kontrolli dhe shkallës së seancës me GPS.

**Rregullimi i shtrëngimit të brendshëm** – Ky rregullim është i dobishëm për kontrollimin e cilësisë së pikave. Secila pikë kontrolli mund të ketë gabimin mesatar individual. Pikat e kontrollit mund të vlerësohen me të njëjtin indikatorë të sigurisë së matjeve. Rregullimi i shtrëngimit të brendshëm nuk përdoret për rregullimin e shtrëngimit definitiv.


**Rregullimi i shtrëngimit definitiv** – Ky rregullim përdoret për të kalkuluar koordinatat dhe lartësitë definitive, si dhe për të vërtetuar saktësinë dhe sigurinë e tyre.

Zakonisht llogaritjet bëhen vetëm me dy metoda:

1. Gjenden dhe korrigohen të gjitha gabimet e mëdha dhe vlerësohet cilësia e matjeve duke përdorur metodën e barazimit të lirë,
2. Kalkulohen koordinatat definitive dhe lartësitë me metodën e rregullimit të shtrëngimit

Pas definimit të rrjetit dhe vendimit mbi metodën adekuate, **parametrat e rregullimit** mund të caktohen në katrarin e dialogut. Mund të miratohen të gjitha vlerat e kritereve statistike

Aktivizohen katroret për **ADV-Mode** dhe **One (global) scale factor**.



→ Fillohet llogaritja me pranimin e vlerave (**Accept values**).

### 8.3 Vlerësimi i Raporteve dhe Rezultateve të Rregullimit

a priori gabimi mesatar: Vlera(madhësia) e gabimit mesatar kuadratik: (pa round off): Madhësia e vlerës së ulët kritike e kuadratit të g.m.	Testi me model global i rregullimit me vlerën kufitare për pranimin apo refuzimin e modelit. Rezultatet e këtyre vlerave varen nga caktimi i gabimeve a priori, por vlera duhet t'i afrohet 1.
Max. i gabimit mesatar të koordinatës	Vlera maksimale e gjysmë-boshteve të mëdha (MeA) e elipsës së gabimit mesatar ose të gabimit më të madh mesatar të lartësisë së pikave të reja
Max. i vektorit të sigurisë	Vlera maksimale e anës së gjatë të katrorkut të sigurisë (NA) të pikave të reja

Vlera e gabimit mesatar të grupeve të vrojtimit	Jep pasqyrën mbi saktësinë e vrojtimeve të ndryshme.  <b>Gr</b> tregon numrin e grupeve të distancave dhe <b>NoObs</b> numrin e vrojtimeve  <b>a apriori</b> dhe <b>a posteriori</b> tregojnë gabimin mesatar të pozitës (përveç koordinatave dhe matjeve GPS), <b>quotient</b> nga këto dy vlera dhe <b>redundanca</b> (teprica) e grupit gjithashtu përmendet. <b>Scale-Corr in PPM</b> tregon korrigjimin eventual të shkallës dhe gabimin e tyre mesatar të pozitës (Me).
---	---

STACIONI I POZITËS - PËRMBLEDHJE E RREGULLIMIT TË KOMBINUAR	Pas informimit mbi matjet stacionare, në reshtin e parë paraqitet numri i vrojtimit, numri i pikës së synuar <b>PointNo</b> , lloji i pikës <b>NP/CP</b> , vrojtimi <b>Obs/Or</b> , numri i distancës ose grupit të drejtimit <b>Gr</b> , korrigimi <b>Corr</b> , korrigimi i katorrit të shkallës së ndërthurjes së diferencës <b>C/C</b> , gabimi mesatar i pozitës a priori për secilin vrojtim <b>M.e</b> , treguesit e sigurisë <b>ZI</b> , <b>NABLA</b> , <b>ËI</b> , <b>GI</b> dhe distanca e azimutit <b>DI/AZI</b> nga koordinatat përfundimtare. Për seanca individuale GPS parametrat e kalkuluar të transformimit dhe gabimi i tyre mesatar tregohen në fillim. Parametrat pëershkruanjë transformimin e koordinatave lokale GPS në rrjetin global të pikave të kontrollit.
SIGURIA E JASHTME	Vektori më i madh për secilën pikë të re, përveç orientimit të katorrit <b>Azimut(NA)</b> përcakton edhe gjysmë-gjatësitë <b>NA</b> . Për përcaktimin e gjysmë-gjëresisë së katorrit <b>NB</b> vektori më i madh ndaj komponentit normal me NA dhe vrojtimit <b>No.B</b> që shkakton përcaktohet. Për rregullimin e lartësisë gjithë vektorët drejtohen në të njëjtin drejtim. <b>NH</b> i përgjigjet vektorit më të madh dhe <b>No.H</b> i referohet vrojtimit, që e shkakton këtë vektor.
KOORDINATAT, ELIPSAT E GABIMIT MESATAR DHE KODET E CILËSISË SË PIKAVE TË REJA	Tri kolonat e para përbajnjë numrin e pikës dhe koordinatat e pozitës Y dhe X. Dy kolonat e ardhshme janë korrigimet <b>DY</b> dhe <b>DX</b> në koordinatat e përafrimit. I përcjell elipsat e gabimit mesatar të pikave të reja me gjatësitë e <b>MeA</b> të madh dhe gjysmë-boshtet e vogla <b>MeB</b> , si dhe azimutin e boshtit të madh <b>MeAz</b> . Elipsat e gabimit kalkulohen me kuotën e gabimit mesatar a posteriori të peshës së njësisë. Kolonat e fundit jepin llojin e pikës <b>PTyp</b> , nivelin e tolerancës <b>TL</b> dhe kodet e cilësisë. Kuota <b>Tol</b> tregon marrëdhënien ndërmjet vlerës së kërkuar dhe

	asaj të arritur.
KOORDINATAT, LLOJI I PIKËS DHE KLASA E TË GJITHA PIKAVE LIDHËSE TË PËRDORURA	Lista e të gjitha pikave të kontrollit të përdorura në këtë llogaritje
PARAMETRAT SHTESË PËR RREGULLIM	Lista e parametrave tjera të llogaritjes dhe statistika mbi numrin e vrojtimeve që kanë kaluar WI – vlerën kufitare

Një rregullim i shtrëngimit definitiv mund të kontrollohet në dokumentet e rrjetës së rendit të III-të të zonës kadastrale të Dobrashecit në AKK .

## 8.4 Raporti dhe Dokumentimi

Dokumentimi i rrjetës referente të rendit të III-të përbëhet nga këto raporte dhe harta:

- Plani i pikave të rrjetit ku janë vërejtur matjet e kryera (Shtojca 2 dhe 3)
- Protokolli i stacionit dhe dokumentet tjera të terrenit
- Hartat e rrjetit me pamje grafike të saktësisë dhe sigurisë.
- Hartat vektore me mbetjet (vlerat, madhësitë) e transformimeve
- Printimi pas rregullimit të lirë të rrjetit
- Printimi i Rregullimit të Shtrëngimit të rrjetit
- Përbledhja e rezultateve në një raport teknik me zbulimet më të rëndësishme
- Inventari i pikave (me ortofoto, skicat e vijave)

## 9. Mirëmbajtja e Rrjetit Referent të Rendit të III-të

### 9.1 Njoftimi dhe organizimi

Zyrat Kadastrale Komunale janë të autorizuara për pikat e rrjetit të rendit të III-të dhe sipas kësaj ato janë organi përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre.

- 
- ZKK-të duhet të ndërtojnë një sistem azhurnimi që duhet të miratohet nga AKK-ja dhe duhet të kryhet në vazhdimësi. Kopjet e protokolleve të azhurnuara të inventarit të pikave duhet të dorëzohen periodikisht (një herë në vit) në AKK.
  - Dendësia e pikave të kontrollit të rrjetit të rendit të III-të duhet vazhdimit të përputhen me kapitullin 2.2.1
  - Këto udhëzime janë valide për përcaktimin e ri, si dhe për mirëmbajtjen e rrjetit referent të rendit të III-të.
  - Pikit e dëmtuara apo të asgjësuara duhet të maten gjatë një periudhe të caktuar të vitiit dhe duhet të kenë saktësi të njëjtë apo më të madhe nga matja e parë.
  - Pikit kontrolluese të Rendit të I-rë dhe të II-të të cilat janë të dëmtuara apo asgjësuara duhet patjetër t'i raportohen AKK-së.

# Shtojca 1

Dukja e Libri të terrenit për Rrjetin referent të rendit të III-të

Emri i pikës _____	Vendi _____
Lartësia e antenës _____	Datë _____
Lloji i instrumentit _____	Operator _____
Vêrejje _____	
<i>Mbi themelimin t bli h t</i>	
Lloji:	
Vêrejje:	
Përpiluar nga:	
Datë:	


  

Emri i pikës _____	Vendi _____
Lartësia e antenës _____	Datë _____
Lloji i instrumentit _____	Operator _____
Vêrejje _____	
<i>Mbi themelimin</i>	
Lloji:	
Vêrejje:	
Përpiluar nga:	
Datë:	

## Shtojca 2


Shembull:

Planifikimi i rrjetit referent të rendit të III-të i paraqitur edhe në ortofoto



## Shtojca 3

Shembull: planë pikash për rjetin referent të rendit të III-të si plotësim i reportit teknik



Kjo kornizë hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe shpalljes

Prishtinë 20.05.2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV  
Prof. Dr. sc Murat Meha



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERTIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS  
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA  
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## KORNIZA

**Nr. AKK 2005/05**

## INSTRUMENTI - STACIONI TOTAL

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke u bazuar  
në Nenin 34.2 të Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25 i miratuar nga  
Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor 2003 i shpallur me Rregulloren e  
UNMIK-ut Nr. 2004/04 dhe Nenit 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.  
MSHP 2004/08 për Zbatimin e Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25,  
me 20.05.2005 aprovon këtë Kornizë si vijon:

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	85
2. PËRGATITJET PARA MATJEVE .....	86
3. MATJET .....	86
3.1 PARAMETRAT E MATJES .....	86
3.2       MATJA .....	90
3.2.1 <i>Procedura fillestare</i> .....	90
3.2.2 <i>Matjet</i> .....	91
3.2.3 <i>Shpjegimi i kodeve dhe karakteristikave</i> .....	92
4. TRANSFERIMI NË KOMPJUTER .....	94
SHTOJCA 1 – NUMËRIMI .....	98
SHTOJCA 2 - KODET.....	99
SHTOJCA 3 – KARAKTERISTIKAT .....	100
SHTOJCA 3 A4 – KARAKTERISTIKAT PËR LLOJET E MATJEVE NË GEOSPRO.....	101
SHTOJCA 4 – PËRSHKRIMI I FORMATIT GSI TË PËRDORUR PËR TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE PREJ INSTRUMENTIT LEICA NË GEOSPRO CALC.....	102

## 1. Hyrje

Ky manual përmban informacione mbi matjet me Stacion-Total Leica TCR303, kështu që të dhënat mund të shfrytëzohen në llogaritjet me programin kompjuterik GeosPro/ProCalc.

Procedurat e përshkruara mbulojnë matjet në vijim:

- Matjet e detajuara me instrument në pikat e njoitura.
- Stacionet e lira dhe matjet vijuese të detajuara.
- Matjet në poligone

Procedurat kryesore janë të njëjta, pavarësisht nga detyrat të cilat duhet të kryhen. Kodet dhe karakteristikat e kodeve janë të vetmet informacione të shfrytëzuara në GeosPro për të ndarë llojet e ndryshme të matjeve për shfrytëzim në kalkulimet e ndryshme.

Supozohet që gjeodeti në përgjithësi ka njohuri në operimin me Stacion-Total. Operimi me instrument është përshkruar në kapitullin 3.5

Ky udhëzim përshkruan mënyrën e kryerjes së një matjeje të vetme të llojeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme. Nuk është libër për matje, që do të përshkruante të gjitha llojet e mundësive dhe gabimeve gjatë matjeve. Ky do të ishte shumë libër i ndërlidhur. Megjithatë, rëndësia e matjeve të shumëfishta (të përsëritura) duhet të përmendet për të gjitha pikat kontrolluese dhe matjet e pikave të detajuara (pikave kadastrale).

Instruksionet më specifike për matjen dhe llogaritjen e poligoneve dhe pikave të detajuara mund ti gjeni në **Korniza nr 2005/06** për poligonet dhe matjet e detajuara.

## 2. Përgatitjet para matjeve

Shih dokumentin Korniza 2005/17 për Mirëmbajtjen e instrumenteve gjëodezike:


- Mbushja e baterive.
- Verifikimi fizik i të gjitha pajisjeve veçanërisht trekëmbëshit dhe mekanizmit optik për centrimin e instrumentit.
- Sigurohuni që TCR303 është në gjendje të rregullt, sipas kushteve të instrumenteve dhe kalibrimit të instrumentit.

## 3. Matjet

### 3.1 Parametrat e matjes

Kur arrihet në terren, ekzistojnë disa parametra që duhet të kontrollohen/vendosen para fillimit të matjes. Këto janë **EDM settings**. Për t'i aktivizuar, shtypet pulla **SHIFT** dhe pastaj **EDM (DIST button)**.

Në ekranin e instrumentit do të paraqitet:



Veçoritë **EDM** përbajnjë një meny të detajuar me zgjedhje për vlera të kërkuarë.

#### Pika laserike

**OFF:** Rrezja e dukshme laserike është e shkyçur.

**ON:** Rrezja e dukshme laserike për vizualizimin e pikës së cakut është e kyçur.

## Dist Mode

Me instrumentet TCR, ekzistojnë mënyra të ndryshme për matjen me **EDM** të dukshme (**RL**) dhe të padukshme (**IR**).

Varësisht nga mënyra e zgjedhur e matjes, llojet e prizmës së zgjedhur janë të ndryshme, shih tabelat me poshtë në anglisht.




RL_SHORT	Short range. For distance measurements without prisms with a target distance up to 80 m (3mm + 2 ppm)	IR_FINE	Fine measuring mode for high precision measurements with prisms (2mm + 2 ppm)
RL_TRACK	Continuous distance measurement without prisms (5mm + 2 ppm)	IR_FAST	Quick measuring mode with higher measuring speed and reduced accuracy (5mm + 2 ppm)
RL_Prism	Long range. For distance measurements with prisms (5mm + 2 ppm)	IR_TRACK	Continuous distance measuring (5mm + 2 ppm)
		IR_TAPE	Distance measurement using Retro targets (5mm + 2 ppm)



With the RL-EDM each object in the beam is measured (possibly also branches, cars, etc.).

## Lloji i prizmës

Gjetja e funksionit në aranzhimet e **EDM**.

Leica Prisms	Constants [mm]	
Standard prism GPH1 + GPR1	0.0	
360° prism GRZ4	+23.1	
Miniprism GMP101/102	+17.5	
Reflective targets	+34.4	
USER	-	is set at "Prismconst" (-mm + 34.4; e.g.: mm = 14 -> input = -14 + 34.4 = 20.4)
RL	+34.4	Reflectorless


## Konstantja e prizmës

Gjetja e funksionit në aranzhimet **EDM**.


Shënimi i një konstanteje të prizmës të specifikuar nga shfrytëzuesi. Të dhënat mund të shënohen vetëm në mm.

Vlerat e skajshme: -999 mm deri në +999 mm

Në radhë është kontrollimi i vlerave ppm. Në ekranin e aranzhimeve **EDM**, <ppm>. Do të paraqitet ky ekran:



Nëse keni barometër dhe/ose termometër, mund të shënoni vlerat nga këto instrumente. Mirëpo, për shumicën e matjeve (nëse distancat nuk janë më shumë se 500-600 m) saktësia do të jetë mjaft e mirë nëse keni vlera të përaferta të shtypjes dhe temperaturës. Për temperaturë mund të jepni atë të afërt. Për shtypje mund të shfrytëzoni shtypjen normale, që është 1013 ba në nivel deti. Por, kjo duhet të korrigohet nëse lartësia është mbi nivelin e detit. Shtypni pullën **SHIFT** dhe pastaj **PgDn** (Page Down) për të dalë tek ekranin numër 2, nën ekranin e parë:



Këtu shkruani lartësinë e përafërt. Kur të ktheheni në ekranin e mëparshëm, duke shtypur pullën **SHIFT** dhe atëherë **PgUp** (Page Up), do të shihni që edhe shtypja edhe vlera për ppm kanë ndryshuar (kjo shtypje është shtypja normale në lartësinë tuaj).


Mos harroni të përfundoni duke zgjedhur **<SET>** në ekran.

Karakteristikat **EDM** mund të ndryshohen edhe pas fillimit të matjes, nëse ka nevojë.

## 3.2 Matja

### 3.2.1 Procedura fillestare

Fillo matjen duke shtypur pullën **PROG**. Dhe do të paraqitet:




Në ekranin e ardhshëm zgjidh **SURVEYING**.

Ndiq udhëzimet:

- **SetJob**

Zgjidh **<NEW>**. Shëno emrin e punës (dhe nëse dëshiron, emrin e operuesit). Mos harro të shtypësh **<SET>**.

- Numri maksimal i punëve që mund të shënohen në memorien e TCR303 është 4. Nëse tashmë keni 4 punë në memorie, duhet të hiqni një ose më tepër punë para se të shkruani një tjetër. Për të bërë këtë, dilni nga programi **SURVEYING**. Shtyp pullën **SHIFT** dhe pastaj **MENU** (pulla **PROG**). Zgjidh **DATA MANAGER, VIEW / EDIT DATA** dhe **JOBS**. Do të paraqitet kjo në ekran:



Zgjedh punën të cilën dëshiron ta heqësh, dhe pastaj shtyp **<DEL>**. Konfirmo këtë me **<YES>**. Përsërit të njëjtën për punën tjetër, ose zgjedh **<EXIT>** (4 herë) për të vazhduar, duke zgjedhur **SURVEYING** përsëri dhe **SetJob**.

- **SetStation**

Shëno emrin e stacionit. Koordinatat mund të caktohen në 0 (ose çfarëdo vlere). Shtyp pullën **CE** dhe pastaj **ENTER** (pulla e kuqe) për të shënuar 0. GeosPro nuk do të shfrytëzojë koordinatat. Konfirmo me **<OK>** dhe shëno lartësinë e instrumentit. Zgjedh **<SET>**.

- **SetOrientation**

Merr si cak pikën orientuese (një pikë markante ) në distancë mbi 100 m. I jep emrin 0 (zero), ose emër tjetër, në vijën që fillon me BsPt. Zgjedh **<Hz0>** për të caktuar këndin në 0. Konfirmo me **<SET>**. GeosPro nuk do të shfrytëzojë këtë orientim. Kjo është vetëm që ju të kontrolloni matjet. Pas mbarimit të matjeve në stacion përsëri duhet të caktohet ky orientim dhe të kontrollohet që vlera e këndit është përafërsisht 0 (toleranca 50<sup>CC</sup>).

- **Start**

Tani jeni gati të matni në pikë.

### 3.2.2 Matjet

Së pari pikë që është caktuar, i jepet emri. Ky emër mund të përmbajë shkronja dhe numra. Numërimi i pikave të rrjetës së rendit të tretë dhe atyre kadastrale duhet të bëhet sipas rregullave të caktuara nga AKK. Shih shtojcën 1 dhe **Kornizën nr 2005/04**.


Pastaj duhet të shënohet lartësia e reflektorit.

Sic është thënë në hyrje, GeosPro përdor kodet dhe karakteristikat e kodeve për të ndarë llojet e ndryshme të matjeve për shfrytëzim në

kalkulime të ndryshme. Këto kode dhe karakteristika duhet të caktohen tani. Sistemi i kodeve dhe karakteristikave është i instaluar në instrumentin tuaj. Ju mund të zgjidhni një kod vetëm duke shënuar vlerën. Nëse dëshironi të shihni të gjitha kodet mund të shënoni \*. Ky simbol do të gjejë 6 pozita mbi shkronjën A në fushën e Shënimit (Input) (shtyp pullën CE dhe pastaj pullën SHIFT. Shtypni pullën e gjelbër "down" të navigimit 5 herë dhe atëherë do të keni \*). Kur shënoni/zgjidhni një nga kodet, vlerat e karakteristikave gjithashtu zgjedhën sipas saj.

Lista e kodeve dhe karakteristikave është përfshirë në këtë doracak në shtojcat 2 dhe 3. Në shtojcën 2 mund të shihni vlerat e dhëna të karakteristikave për secilin kod. Shtoja 3A tregon disa shembuj mbi dhënien e karakteristikave të kodit.

Pas zgjedhjes së kodit, paraqitet kjo:



Nëse doni të shihni apo të ndryshoni karakteristikat, zgjidhni **<ATTR>**. Mos harroni të regjistroni kodin e zgjedhur dhe karakteristikat me **<SET>** (ose **<REC>**).

Nëse caku është shënuar drejt, shtypni pullën **ALL** për matje dhe shënim të matjes në memorien e instrumentit.

Caku i njëjtë mund të shënjohet dhe matet disa herë dhe në dy pozitat e instrumentit. Megjithatë, nëse jeni duke matur një poligon, duhet të shënjeni të gjitha pikat njëjtë në secilën pozite.

### 3.2.3 Shpjegimi i kodeve dhe karakteristikave

Kodi jep informacione mbi gjendjen fizike të pikës së shënuar. Për shembull, mund të jetë një kunj metalik apo plastik, varësisht nga kodi.

Kodet ndahen në klasa. Ekzistojnë klasat në vijim:

- Pikat kufitare
- Pikat kontrolluese
- Pikat e mëparshme
- Pikat e situacionit
- Pikat e niveluara
- Pikat projektuese
- 


Të gjitha kodet i përkasin njërës, dhe vetëm njërës, nga këto klasa.

Karakteristika jep informacione mbi llojin e kalkulimit të planifikuar për matjen e pikave. Për shembull, mund të përdoret në kalkulimin e poligonit, ose në kalkulimin me stacion të lirë varësisht nga vlera e karakteristikave.


Mundësia – vendosja e cakut

Nëse nuk është e mundur të vendoset reflektori direkt ose nuk është e mundur të shënjohet pika e cakut direkt, vlerat e ofsetit (gjatësia, kryqi apo/dhe vendosja e lartësisë) mund të shënohen gjatë matjes. Vlerat për këndin dhe distancat kalkulohen direkt për pikën e shënjuar.

Kjo është situata:



Opsioni bëhet i mundur duke shtypur pullën **SHIFT**, dhe pastaj **FNC** (pullën **USER**). Zgjidh **OFFSET** në ekran, dhe atëherë paraqitet ekran 2D **OFFSET**. Duke shtypur pullën **SHIFT** dhe **PgDn** (pulla e gjelbër) paraqitet kjo:




Shih doracakun e shfrytëzuesit (user manual – versioni anglisht 3.5, faqe 35) për procedurën.

## 4. Transferimi në kompjuter

Për të transferuar matjet, lidhet Stacioni -Total me kompjuter me kabllon e transferimit.


Parametrat e komunikimit duhet të vendosen në të njëjtën mënyrë si për instrument edhe për kompjuter. Mund të verifikohet:

Në Stacion-Total shtypet pulla SHIFT dhe pastaj **MENU** (pulla **PROG**). Zgjidh **ALL SETTINGS**, dhe pastaj **COMMUNICATION**. Duhet të paraqitet kjo:



Bëni ndryshimet e nevojshme, dilni nga ekranin i komunikimit (shtyp pullën **EXIT** 3 herë) dhe ndalni instrumentin.


Në kompjuter ndezët programi **Leica SurveyOffice**. Zgjedhni Settings dhe sigurohuni që ekrani duket kështu:




Bëni ndryshimet e nevojshme dhe klikoni në **OK** për të konfirmuar.

Zgjidh **Data Exchange Manager**. Stacion-Totalet ndizen automatikisht (sipas përvojës, transferimi shkon më lehtë kur Stacionit-Total ndizet nga programi i kompjuterit).


Do të duhej të fitoni një ekran pak a shumë si ky:



Pjesa e majtë paraqet Stacionin-Total ndërsa e djathta kompjuterin. Zgjidh punën nga Stacion-Total dhe folderin e kompjuterit i cili do të përbajë atë, duke klikuar në +. ekrani në kompjuterin tuaj do të duket si ky:



Me pullën e majtë të mausit, shtyp **Measurement Data**. Derisa pulla e mausit është e shtypur, kapni dhe lëshoni matjet në folderin e destinimit (rasti konkret *Rabit*). Shtypni pastaj trekëndëshin e zi në dritaren e formatizimit. Do të fitoni një ekran si ky:



Zgjidh formatin **GSI\_GeosPro**, shtyp pullën **OK** dhe fillon transferimi.

Këtu mund të shihet dosja (këtu A.gsi). Format i dosjes duhet të jetë gjithmonë gsi. Kjo është dosje **ASCII** dhe mund të përdoret edhe në programin **Notepad** për shembull. Shtojca 4 jep shpjegime mbi fushat e ndryshme të kësaj dosjeje.

## Shtojca 1 – numërimi

### Pikat e rrjetit të rendit të tretë:

(aplikohen për kodet 11-14, shih shtojcën 2)

Numri gjithmonë duhet të përbëhet nga **6 shifra**:

**XXYYYY**

- **XX** është numri i komunës.
- **YYYY** është numri në vijim, ku
  - ✓ Pikat e matura me GPS kanë rezervuar numrat 1 – 1000.
  - ✓ Pikat e matura me Stacion-Totale fillojnë me numrin 1001.

### Pikat e detajuara:

(aplikohen për kodet 1-7 dhe 40-63, shih shtojcën 2)

Numri gjithmonë duhet të përbëhet nga **9 shifra**:

**XXYYNNNNN**

- **XX** është numri i komunës.
- **YY** është numri i zonës Kadastrale (merren veten dy numrat e fundit)
- **NNNNN** është numri i rezervuar për numërim (nga 00001-99999)


## Shtojca 2 - kodet

Kodi	Pikat kufitare	Karakteristika
1	Monument	9
2	Kunj metalik	9
3	Kryq	9
4	Kunj plastik	9
5	E pashënuar	9
6	Kunj	9
7	Gyp	9
<b>Pikat e kontrollit</b>		
11	CP3_MCO Monument	0
12	CP3_MCO Kunj metalik	0
13	CP3_MCO Kryq	0
14	CP3_MCO Gyp	0
15	CP3_MCO e pashënuar/kunj	0
16	CP3_MCO Pikë e lartë (antenë, kishë, xhami)	8
20	CP1_KCA	8
21	CP2_KCA	8
<b>Pikat e mëparshme</b>		
30	FPPos	8
31	FPLev	5
32	FPPhoto	5
<b>Pikat e situacionit</b>		
40	SP Pikat e ndërtesës, muret	5
41	SP Ujërat	5
42	SP Skaji i malit	5
43	SP Anë rruge	5
44	SP Shenja tjera të tokës	5
45	SP Pika boshtore	5
46	SP Gur kilometrik (monument historik???)	5
47	SP Dru i rëndësishëm	5
48	SP Kullë drejtimi, shtyllë ajrore	5
<b>Pikat nivizuese</b>		
50	SP Pika nivizuese me tekst (në hartë)	5


51	SP Pika nivelize pa tekst (në hartë)	5
52	SP Pika nivelize projektuese me tekst (në hartë)	5
53	SP Pika nivelize projektuese pa tekst (në hartë)	5
<b>Pikat projektuese</b>		
60	Pr Pikat projektuese Ndërtesa	5
61	Pr Pikat projektuese Kufiri	5
62	Pr Pikat projektuese Boshti	5
63	Pr Pikat projektuese Tjera	5

### **Shtojca 3 – karakteristikat**

- 0 Pika poligonale (traverse)
- 1 Drejtimi për dokumentim (joaktiv)
- 2 Stacioni i lirë
- 5 Drejtimi për pikën e situacionit
- 6 Drejtimi për kontroll
- 8 Drejtimi për orientim
- 9 Drejtimi për pikën kufitare

**Shtojca 3A4 – karakteristikat për llojet e matjeve në GeosPro**

## Shtojca 4 – përshkrimi i formatit GSI të përdorur për transferimin e të dhënave prej instrumentit Leica në GeosPro Calc



**Rreshhti i matjes me ID e pikës, këndi horizontal- vertikal, distanca e rënies, ppm, add.-onst.**

410001+00000021	42...+00100005	43...+00001620	44...+00000012	45...+00001013
410001+00000031	42...+00000014	43...+00000008		
410001+00000032	42...+00001300			
110001+00100004	21.024+01610479	22.024+08730542	31...0+00033098	51....+0008+018
410002+00000031	42...+00000014	43...+00000008		
410002+00000032	42...+00001300			
110002+00100004	21.024+19610488	22.024+27223486	31...0+00033103	51....+0008+018
410003+00000031	42...+00000014	43...+00000008		
410003+00000032	42...+00001300			
110003+01000010	21.024+33733330	22.024+08643086	31...0+00029036	51....+0008+018
410004+00000031	42...+00000014	43...+00000008		
410004+00000032	42...+00001300			
110004+01000010	21.024+15733324	22.024+27311342	31...0+00029042	51....+0008+018
410005+00000031	42...+00000014	43...+00000008		
410005+00000032	42...+00001300			
110005+00100006	21.024+25028236	22.024+09009358	31...0+00036064	51....+0008+018

Kjo kornizë hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe shpaljes

Prishtinë 20.05.2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV  
Prof. Dr. Sc Murat Meha



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS  
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA  
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## KORNIZA

**Nr. AKK 2005/06**

## POLIGONET DHE MATJET E DETAJIT

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke u bazuar në Nenin 34.2 të Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor 2003 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/04 dhe Nenit 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/08 për Zbatimin e Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25, me 20.05.2005 aprovon këtë Kornizë si vijon

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>105</b>
1.1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME .....	105
<b>2. POLIGONET DHE MATJET E DETAJE_(PUNA NË TERREN) .....</b>	<b>105</b>
2.1     BAZA .....	105
2.2     DIZAJNI DHE LIDHJA .....	105
2.3     LLOJI I POLIGONEVE.....	106
2.4     ORIENTIMI NË PIKAT E NJOHURA .....	106
2.5     STACIONI I LIRË.....	107
2.6     LARTËSITË DHE MATJA E POZITËS SË DYTË .....	107
<b>3. MATJET DETAJE .....</b>	<b>107</b>
3.1     PIKAT KUFITARE.....	107
3.2     NDËRTESAT ( OBJEKKTET ) .....	107
<b>4. LLOGARITJA E KOORDINATAVE_(PUNA NË ZYRË) .....</b>	<b>108</b>
4.1     REGJISTRIMI I MATJEVE POLARE .....	108
4.2     PARAQITNI DHE EDITONI MATJET POLARE .....	109
4.2.1 <i>Shikimi ( paraqitja ) i të dhënave të matura .....</i>	<i>109</i>
4.2.2 <i>Editimi i matjeve .....</i>	<i>110</i>
4.3     ORIENTIMI .....	111
4.3.1 <i>Definimi i poligonit.....</i>	<i>112</i>
4.3.2 <i>Llogaritja e poligoneve .....</i>	<i>112</i>
4.4     PIKAT E KUFIRIT DHE TË DETAJIT .....	114

## 1. Hyrje

### 1.1 Rregullat e përgjithshme

Ky udhëzim do të jetë një përshkrim i detajuar i procedurave për krijimin e poligoneve, për matjet e detajuara, për procesin e rindërtimit dhe të mirëmbajtjes së kadastrit. Udhëzimet janë krijuar në pajtim me *Udhëzimet Teknike për Shërbimet Kadastrale* (Dokumenti 060-001), me *Planin e punës përrjetin referent të rendit të III<sup>të</sup>* (Dokumenti 020-009/010, SGU 2001), si dhe **Korniza nr 2005/05** (Dokumenti 070-004).

Udhëzimet duhet të kuptohen si rregulla të përgjithshme apo të krijohet dhe të kryhet rrjeti i rendit të III<sup>të</sup> në atë zonë kadastrale apo në atë rajon. Përcaktimi i koordinatave do të bëhet në sistemin KOSOVAREF01.

Pikat ekzistuese të rrjetës gjeodezike nga sistemi i mëparshëm FRYREF30, mund të shfrytëzohen si pikat kontrolluese për testimin e cilësisë së transformimit.

## 2. Poligonet dhe matjet e detaje (puna në terren)

### 2.1 Baza

Poligonet janë të bazuara në rrjetin referent të rendit të dytë dhe të tretë. Pikat e reja duhet të vendosen aty ku janë të dobishme për matjen e pikave kufitare, këndeve të shtëpive apo rilevime të tjera, etj.

Poligoni duhet të dizajnohet dhe të njihet në terren, pikat duhet të vendosen dhe të shënjohen me shtylla hekuri, betoni apo monumente ekzistuese në gjendje të mirë.


### 2.2 Dizajni dhe lidhja

Dizajnimi i poligonit në terren duhet të bëhet, sipas nevojave të matjes. Poligonet janë të lidhura në pikat e rendit të III-të apo të II-të dhe gjithashtu në pikat e reja poligonale.

Duhet të krijohet lidhja sa më e përshtatshme. Kryqëzimi i poligoneve nuk është i lejuar. Minimumi i distancës ndërmjet 2 pikave fqinje në poligon duhet të jetë 30 m.

## 2.3 Lloji i poligoneve

Ekzistojnë 4 lloje të ndryshme të poligoneve që shfrytëzohen me softuerin ProCalc:



- Connected to/Conpolygonet, (me rregullim këndor dhe koordinata)
- Pika Nyje
- Pa kënd mbyllës (pa "hint rennet", vetëm me rregullim koordinatash)
- I hapur

Duhet insistuar në llojin *Connected to (conpolygonet)* me orientim në pikën filluese dhe mbaruese.

Poligonet në pikë nyje (knotted) shfrytëzohen në rast të poligoneve shumë të gjata. Nëse ekziston rrjeti referent i rendit të III<sup>te</sup> atëherë nuk shfrytëzohet më.

*Pa kënd mbyllës (pa hint rennet)* shfrytëzohet nëse nuk ka orientim në pikën mbaruese.

Duhet t'ju shmangemi poligoneve të hapura. Nëse nuk ka zgjidhje tjetër, stacioni duhet të kontrollohet në mënyrë indirekte me përcaktim të dyfishtë mbi pikat kufitare.

## 2.4 Orientimi në pikat e njohura

Në secilin stacion të njohur (pikë me koordinata ekzistuese) duhet të vrojtohet së paku në një pikë tjetër të njohur për të llogaritur orientimin. Drejtimi kontrollues, në "pikë të lartë" (shtyllë, xhami, tymtar, apo nga një objekt tjetër i rëndësishëm) duhet të kontrollohet në fillim dhe në fund të matjeve (stacionit) për të vërejtur diferençat gjatë matjeve. Diferenca nuk duhet të jetë më shumë se 1°.

Në rast të vendosjes së shumëhershme të instrumentit në stacionin e njëjtë, mund të shmangen problemet gjatë llogaritjes së orientimit.

**Gjithnjë zgjidhni drejtimin në pikën shënjuese me vlerë të njëjtë.** (preferohet në 0.00°)

## 2.5 Stacioni i lirë

Përveç poligoneve për matje shtesë mund të përdoren edhe stacionet e lira për përcaktimin e dyfishtë të pikave kufitare. Ato duhet të lidhen së paku për 2, 3 e më tepër pika kontrolluese.

## 2.6 Lartësitë dhe matja e pozitës së dytë

Poligonet duhet të maten dhe të llogariten me lartësi. Lartësitë janë informacione të rëndësishme për kadastër dhe për qëllime tjera ( ndërtimtari ).

Matjet e pikave poligonale me distanca shumë të mëdha (1 km) duhet patjetër matjet të bëhen në dy pozita të dylbisë me Stacion-Total ( që të eliminohet gabimi i instrumentit )

# 3. Matjet detaje

## 3.1 Pikat kufitare

Në rajonet urbane dhe rurale pikat kufitare duhet të jenë të shënjuara me monumente (gurë), shtylla druri apo hekuri. Shënjimi mund të mos ekzistojë nëse kufiri është përgjatë rrugëve, gardheve, mureve apo kufij tjerë natyrorë.

Kufijtë e parcelave duhet të identifikohen dhe të verifikohen së bashku me pronarin apo poseduesin e tokës. Shenjat të cilat mungojnë duhet të rivendosen para kryerjes së matjeve (për më tepër shiko ligjin mbi kadastrën ).

Së paku 30% e pikave kufitare duhet të maten dy herë (nga dy stacione). Së paku 1-3 pika prej secilit stacion duhet të maten si përcaktim i dyfishtë.

## 3.2 Ndërtesat ( objektet )

Shtëpitë e reja duhet të maten në 3 qoshe në ballët kryesore. Nëse së paku 2 qoshe mund të merren, gjatësia dhe gjërësia e shtëpisë duhet të matet me metër shirit.

## 4. Llogaritja e koordinatave


### (Puna në zyrë)

#### 4.1 Regjistrimi i matjeve polare

Referohuni tek **Korniza nr 2005/05** se si të barten matjet nga stacioni total në kompjuter dhe si të krijohen dosjet *GSI Files* me softuerin **leica survey office**.

Dosja *GSI Files* duhet të bartet në bazën e të dhënavë të matjeve duke shfrytëzuar programin kompjuterik (softuerin **Geos Pro**).

Aktivizoni menynë **ProCalc > Measurement data >Import polar measurements** dhe do të shfaqet dialog box-i i mëposhtëm.



→ Zgjidhni formatin **GSI Format**

→ Zgjidhni **Nature Code**(kodin natyral) i cili përdoret më së shumti për stacionet nga lista e dytë e katorrit *second list box* (15 = kunj i drunjte)

→ Aktivizoni shenjën për **Interactive Transfer** (bartjen bashkëvepruese) që të keni mundësi të bëni zgjidhje në rast të gabimeve.

→ Aktivizoni shenjën për matjet **X-measurements** (anuloni vlerat) në rast të gabimeve.

→ Aktivizoni shenjën **print a log file** për të gjitha gabimet.

→ Në anën e djathtë të (kutisë) katrорit të dialogut zgjidhni ***Distomat*** dhe ***Theodolite*** nga lista e kutisë. Nëse lista në kuti është e zbrazët duhet ta kompletoni sistemin e të dhënavë ***System data*** në **ProCalc**.

→ E njëjtë është edhe në ***Reg. Instrument*** dhe ***Operateur***, nëse nuk ka asnë vlerë në dispozicion përcaktioni ato në tabelat **G5Operateur** brenda **GRIVIS-GEOS > Messdaten > Terrestrisch**.


→ Filloni të bëni importimin duke shtypur sustën **Start Import**.

Këto matje do të ruhen në bazën e të dhënavë sipas modeli të të dhënavë ( **Data Model** )

## 4.2 Paraqitni dhe editoni matjet polare

Tani matjet janë ruajtur në bazën e duhur të të dhënavë( **Data Model** ) dhe mund të paraqiten me **GRIVIS-GEOS > Messdaten > Terrestrisch > G5Messblatt**.

Aty mund ta gjeni tabelën për të gjitha stacionet e matura.



### 4.2.1 Shikimi ( paraqitja ) i të dhënavë të matura

Klikoni në menynë **Connected Values** dhe zgjidhni **ME\_Ter\_G5Messung**. Të gjitha të dhënat nga stacionet e zgjedhura paraqiten në tabelë si me poshtë.

The screenshot shows a Windows application window titled "ME\_Ter\_G5Messung ((StandPtId = 'z3f0d705000000088'))". The window contains a table with the following columns: Station, MessTyp, State, Target p..., Natu..., Dist, VerticalA1, Horizontal..., InstrH, Targ.., and Date. The data in the table is as follows:

Station	MessTyp	State	Target p...	Natu...	Dist	VerticalA1	Horizontal...	InstrH	Targ..	Date
30013	PMESS	neu	30004	11	120.879	100.166	268.12378	1.485	1.500	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	110	5	12.507	99.046	264.33544	1.485	1.500	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	116	5	109.488	101.258	109.38471	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	117	5	108.929	101.431	112.01131	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	118	5	116.467	100.829	126.53577	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	119	5	136.976	100.370	136.59486	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	120	5	182.833	100.564	130.01540	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	121	5	212.299	99.082	138.48169	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	122	5	216.373	100.475	127.01096	1.485	0.000	10/07/2003
30013	GMESS	berechnet	123	5	215.872	100.654	119.45488	1.485	0.000	10/07/2003
30013	PMESS	neu	30010	11	584.243	99.187	276.48160	1.485	1.500	10/07/2003

Nëse e hapni këtë tabelë për herë të parë, do të shfaqen disa veti, apo tipare (attribute) të panevojshme.

Klikoni me tastin e djathtë në emrin e kolonës dhe dritarja që shfaqet pandërprerë e fsheh **hide** apo mund ti shihni **show some** disa nga kolonat.

Selektimi i rregulluar dhe i definuar i veticë (attributeve) dhe emërtimeve (labels) mund të eksportohet dhe importohet në një bazë tjetër (të re) të të dhënavë.

Me dritaren **GRIVIS-GEOS > Options > Export fieldnames.. > Import fieldnames..**

Dosja e eksportuar / importuar është një dosje tekst (**text file**), tek e cila nuk mund të futen të dhëna në editor (botim).


#### 4.2.2 Editimi i matjeve

Mund të editohen matjet të cilat janë ruajtur në tabelën **G5Messung**. Klikoni në të dhënat e terrenit të cilat do ti editoni, ndryshoni vlerat dhe ruani ato duke klikuar me tastin e djathtë dhe **save**.

Për sortimin e të dhënavë sipas llojit, klikoni në **To sort the data**, klikoni me tastin e majtë në emrin e kolonës. Duke klikuar për herë të parë, të dhënat janë klasifikuar nga lartë poshtë **ascending**, ndërsa kur të klikojmë për herë të dytë nga poshtë lartë **descending**, ndërsa për herën e tretë nuk ka sortim **no sort**.

### 4.3 Orientimi

Bëni llogaritjen e orientimit në pikën e fillimit dhe gjithashtu nëse është e mundur edhe në pikën e fundit të poligonit (para se të llogaritni poligonin).



Nga ProCalc shfrytëzoni menynë “**Takes**” > **Orientation Batch** për të gjetur orientimin nga stacionet e zgjedhura (sipas On line Help)

Nëse disa herë keni bërë matje në të njëjtin stacion dhe keni shfrytëzuar orientime të ndryshme, vegla **the tool** u jep të gjitha rezultatet. Matjet trajtohen sipas grupeve të ndryshme, sipas lartësive të ndryshme të instrumentit, sipas datave të ndryshme, gjithashtu matjet ndahen në grupe të ndryshme.

Për ta qartësuar gjendjen dhe për ta zgjedhur orientimin e saktë për qëllimet tuaja, shfrytëzoni menynë “**Orientation Interactive**”. Vendosni shenjën në pozitën ku orientimi është i saktë dhe

futeni lartësinë e instrumentit nga terreni (para se të pranoni orientimin)

### Poligonet


Në ProCalc në menynë e pikës “**Fixpoints**” paraqiten detyra të ndryshme për llogaritjen e poligoneve.

- Definicioni i poligoneve
- Llogaritja poligoneve

### 4.3.1 Definimi i poligonit

Fillimisht definohet poligoni duke e emëruar atë, për shembull TR01, TR02, TR03 etj. Duhet ta zgjidhni llojin Type nga lista në kuti (Llojin shihni kapitullin 2.3) për të definuar nivelin e tolerancës së shfrytëzuar. (Niveli i tolerancës për sipërfaqet urbane është 2, për sipërfaqet rurale është 3, ndërsa për ato malore 4.)

- ➔ Vendosni shenjën në checkbox-in përgjegjës nëse dëshironi të llogaritni lartësitë.
- ➔ Plotësoni numrat e pikave nga pika filluese deri tek pika e mbarimit të poligonit. Në pikën e fillimit dhe në pikën e mbarimit kodi natyral *natural code* shfaqet automatikisht. Për pikat e reja duhet të zgjidhni nga lista në kuti *list box*.




Në anën e djathtë mund ti shihni shenjat me ngjyrë hiri. Kjo do të thotë se të gjitha matjet e nevojshme janë në dispozicion.

- ➔ Ruani definimin duke shtypur sustën "Accept"

### 4.3.2 Llogaritja e poligoneve

- ➔ Filloni llogaritjen e poligoneve me hyrjen e dytë në menynë "Fixpoints".
- ➔ Zgjidhni rreshtin e poligoneve çka dëshironi të llogaritni (nga-deri), shembull nga TR01 deri në TR03.
- ➔ Vendosni 3 shenja për checkbox-at *Interactive, gjithashtu shfrytëzon poligonet e llogaritura*, nëse gjeni gabime, bëni llogaritjen e hapur. *Use calculated poligone as well, If errors, calculate open.*



Nëse rezultatet e matjeve dhe llogaritjes është brenda tolerancës-gabimit të lejuar, pikat automatikisht janë të azhurnuara në bazën e të dhënave. Rezultatet janë të dokumentuara në reportin përfundimtar.

## LLOGARITJA E PIKAVE FIKSE TË LIDHURA ME POLIGONIN TR01

ADV-mode	Toleranca 3	Faktori i tolerancës 1.000							
K-Wert	0.130	Me reduktim në projekzion							
<b>VLERAT HYRËSE</b>									
Stacioni Pika shënjuese									
30003	30011	67.00543 0.00000	0.00000 0.00000	67.00543 91.290	91.290 -0.002	91.282 91.283	89.46286 89.42519	1.530 1.460	1.800 2.000
30011	30003	69.55455	0.00000	69.55455 214.53544	91.292 153.905	91.283 153.892	89.42519 90.01308	1.460 1.460	2.000 2.000
30011	30012	214.53544 0.00000	0.00000 0.00000	214.53544 0.00000	153.905 0.003	153.892 0.003	90.01308 89.32502	1.460 1.370	-0.066 -0.018
30012	30011	235.38471	0.00000	235.38471 40.30574	153.907 416.839	153.889 416.770	89.32502 90.44101	1.370 1.370	2.000 2.000
30012	30004	40.30574 0.00000	0.00000 0.00000	40.30574 246.34207	416.839 416.846	416.770 416.766	90.44101 89.09487	1.370 1.390	-5.974 0.014
30004	30012	246.34207	0.00000	246.34207	416.846	416.766	89.09487	1.390	1.500
									5.987

## LLOGARITJA E PIKAVE FIKSE TË LIDHURA ME POLIGONIN TR01

ADV-mode	Toleranca 3	Faktori i tolerancës 1.000							
K-Wert	0.130	Me reduktim në projekzion							
<b>Numbri A:</b>									
Shuma S: 661									
Numbri A:	4	Fw: 0.00164	dY: 0.013	Fs: 0.085	Fh: 0.008				
Toleranca:		0.03144	dX: 0.084	Toleranca: 0.615	Toleranca: 0.403				
% der Tol:	8			% der Tol: 13	% der Tol: 2				
<b>Numbri</b>									
30003	NC 11	Cl 0	Këndi 67.00543	Azimuti 262.13014	D e kuqe 91.282	Y-kord. 7494279.059	X kord. 4723884.662	DHLartësia 620.828	Orientimi 195.12030
30011	15	2	144.58089	227.11144	153.891	7494188.619	4723872.312	620.916	12.17388
30012	15	2	164.52103	212.03288	416.768	7494075.731	4723767.747	620.321	171.32429
30004	11	0	246.34207			7493854.528	4723414.584	-5.975	614.346
								145.29123	


Në pjesën e parë të raportit mund ta shihni krahasimin e matjeve të mëhershme dhe të tashme.

Në pjesën e dytë mund ta shihni rezultatin përfundimtar me devijimin FW në kënd (orientimi), vlerat e Y- dhe X- dhe lartësinë.

#### 4.4 Pikat e kufirit dhe të detajit

Pasi të llogaritni poligonin ju mund të filloni me llogaritjen e pikave të detajit në modelin e të dhënavë (pikat e kufirit, këndet e shtëpisë, pikat e tjera).

Në **ProCalc Menu > Takes > Polar takes Batch.**



Rreshti i parë u jep mundësinë të zgjidhni vargun e stacioneve të shfrytëzuara.

Në rreshtin e dytë, në vend të stacioneve mund ta zgjidhni vargun e ndryshimeve **Mutations**.

Vendosni të gjitha shenjat në *checkbox* që të keni një *log file* rreth gabimeve dhe rezultateve të duhura për koordinatat e llogaritura (shihni detajet në *On line Help*). Më poshtë në listën e kutisë, protokolli duhet të vendoset në versionin më të shkurtër *Short version*. Me *Full protocol* do ti keni informacionet e hollësishme rreth rezultateve, të cilat zënë mjaft vend dhe letër në raport.

Filloni llogaritjet duke shtypur sustën **calculation** për ta filluar procesin rrjedhës(vijues). Të gjitha orientimet e nevojshme do të hapen automatikisht. Nëse ende ka pika të pa llogaritura, ato i shfrytëzoni si stacione apo pika lidhëse, por nuk do të kryhet llogaritja për këto matje.

Gjatë procesit të llogaritjes të gjitha matjet në tabelën **G5Messung** do të azhurnohen, dhe fusha **Zustand**<sup>1</sup> do të ndryshojë prej *new* në **berechnet**<sup>2</sup>.

Kjo kornizë hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe shpalljes

Prishtinë 20.05.2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV  
Prof. Dr. Sc Murat Meha



---

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS  
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA  
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

**KORNIZA**  
**Nr. AKK 2005/07**

**EDM KALIBRIMI I INSTRUMENTEVE NË BAZËN  
KONTROLLUESE ZYRTARE**

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke u bazuar në Nenin 34.2 të Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor 2003 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/04 dhe Nenit 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/08 për Zbatimin e Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25, me 20.05.2005 aprovon këtë Kornizë si vijon

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>117</b>
<b>2. BAZA KALIBRUËSE .....</b>	<b>117</b>
<b>3. MATJET .....</b>	<b>117</b>
3.1 PËRGATITJA NË ZYRË.....	117
3.2 PËRGATITJET NË TERREN .....	118
3.3 MATJET NGA SHTYLLAT.....	119
<b>4. LLOGARITJET DHE DOKUMENTACIONI .....</b>	<b>119</b>
4.1 KRIJIMI I 2 FOLDERËVE DHE NJË DOSJEJE (FILE).....	119
4.2 DEFINICIONI I PROJEKSTIT (PROJECT DEFINITION) .....	120
4.3 LLOGARITJA – PREZANTIMI NË LOG-FILE .....	121
<b>5. ANALIZA E REZULTATEVE .....</b>	<b>122</b>
<b>6. CERTIFIKATA.....</b>	<b>123</b>
<b>SHTOJCA 1 – FORMULARI PËR MATJET NË TERREN (1).....</b>	<b>123</b>
<b>SHTOJCA 2. FORMULARI PËR MATJET NË TERREN (2).....</b>	<b>124</b>
<b>SHTOJCA 3 – DOKUMENTACIONI, LOG-FILE-I.....</b>	<b>125</b>
<b>SHTOJCA 4 – CERTIFIKATA .....</b>	<b>129</b>
<b>SHTOJCA 5. HARTA ME LOKACIONIN (VENDIN) E PIKAVE TË BAZËS KALIBRUËSE-NOVOBËRDË.....</b>	<b>130</b>

## 1. Hyrje

Nevoja për kontrollimin dhe rregullimin e instrumenteve matëse është në Kornizën nr 2005/17( Nr. 2.4 Verifikimi dhe mirëmbajtja e instrumenteve matëse). EDM dhe kalibrimi është pjesë e verifikimit të tillë dhe duhet të kryhet në baza të aprovuara. Në Kosovë ekziston një bazë e aprovuar. Për sigurimin e besueshmërisë në punën profesionale të matjes të gjithë EDM-ët (stacionet totale) duhet të kalibrohen së paku një herë në vit dhe gjithnjë pas prishjes/riparimit. Edhe nëse instrumenti është i kalibruar para se të dërgohet nga furnizuesi, transporti mund të shkaktojë nevojën për kalibrim të ri.

## 2. Baza kalibruese

- Në komunën e Novobërdës afër fshatrave Svraçak dhe Tanaskovci janë vendosur 7 shtylla betoni(shihni hartën në shtojcën 5).
- Ato janë të vendosura në linjë të drejtë, 6 të parat me një lartësi 800 deri 850 metra, ku shtylla e 7 është më e gjatë dhe në lartësi 925 metra mbi nivelin e detit. Në atë sipërfaqe nuk ka vegjetacion, kështu që mund të shkohet tek shtyllat edhe këmbë edhe me ndonjë veturë më të fortë. Gjatësia ndërmjet shtyllës 1 dhe shtyllës 7 është 1830 metra.
- Shtyllat janë të larta 120 cm mbi tokë dhe një diametër përafersisht 30 cm, dhe janë të përforcuara në tokën me gurë (gurishtë)

## 3. Matjet


### 3.1 Përgatitja në zyrë

- Pajisjet matëse:
  - **EDM/ Stacionet Totale te cilat duhet të kalibrohen (përfshirë TRIBRACH BAZËN)**
  - 5 baza shtesë (tribraches)
  - 5 reflektorë me tabela shënjuese
  - 5 mbajtës të rrafshët
  - Barometër


- Termometër
- Të tjera:
  - Kaçavidë e rrafshët dhe çekan për të hequr kapakun e shtyllave
  - Bllok shënimesh për të shënuar temperaturën, shtypjen, largësinë, lartësinë e instrumentit dhe lartësinë e reflektorit (shtojca 1 dhe 2)

### 3.2 Përgatitjet në terren

Duhet ta dini se disa stacione totale mund të kenë ndonjë gabim të vrojtimit. Kjo do të thotë se sinjali maksimalisht nuk korrespondon me vizuren optike të reflektorit. Kërkesa për saktësi të madhe nuk mund të toleroj këto gabime, ky gabim është i madh (Saktësia mund të ndikoj që ky gabim të jetë i madh.) Prania e gabimit të tillë mund të kontrollohet para se të fillojnë matjet në bazë kontrolluese. Nëse keni instrumentin Leica TCR303 shtypni sustën SHIFT dhe pastaj EDM (sustën DIST). Zgjidhni pamjen e poshtme: Shtypni sustën SHIFT dhe pastaj PgDn (sustën e gjelbërt poshtë). Do të paraqitet kjo pamje:



Zgjidhni <INJAL> dhe do të keni këtë pamje:



Vrojtoni reflektorin dhe kontrolloni sinjalin duke vrojtuar jashtë reflektorit (prizmës) horizontalisht dhe vertikalisht. Sinjali më i fortë do të jetë kur vizura optike është në qendër të reflektorit.

### 3.3 Matjet nga shtyllat

Vendosni instrumentin në shtyllën 1 (shtylla e fillestare në jug) ndërsa reflektorët në shtyllat 3 - 7. Kryeni matjet me të gjitha instrumentet të cilat duhet të kalibrohen. Të gjitha matjet duhet të kryhen dy herë – duke vrojtuar jashtë objektivit (reflektorit) horizontalisht dhe vertikalisht ndërmjet secilit. Lëvizni reflektorin nga shtylla 3 deri tek shtylla 2 dhe përfundoni me të gjitha instrumentet tek shtylla 1.

Lëvizni instrumentet në shtyllën 2 dhe ktheni reflektorin prapë tek shtylla 3. Kryeni matjet me të gjitha instrumentet.

Procedurat e njëjta duhet të kryhen me instrumente në pjesën tjetër të shtyllave. Veni re se në çoftë se është e pamundur të matet nga shtylla 3 deri tek shtylla 6, është e nevojshme vetëm të matet përpara linjës. Mbani mend të vendosni kapakun në shtyllë pasi të përfundohet shtylla.

**Me rëndësi:** Kur masim, temperatura dhe shtypja e ajrit në instrumente duhet të jetë në lidhje me atmosferën:

- 12 °C
- 760 mm Hg (= 1013,3 mbar)

Temperatura aktuale, shtypja dhe koha duhet të shkruhen në formë, si në shtojcën 1, çdo herë kur instrumenti apo reflektori të vendoset në shtyllë, dhe gjithashtu kur reflektori të çmontohet. Veçanërisht janë të rëndësishme matjet korrekte të temperaturës (nën hije). Gjithashtu, distanca, lartësia e instrumentit dhe lartësia e reflektorit mund të shkruhen në formë, si në shtojcën 2. Nëse ju preferoni në vend të distancës mund t'i ruani në instrument dhe pastaj ti shtypni më vonë në zyre lartësinë e instrumentit dhe lartësinë e reflektorit.

Lartësia për shtyllat merret kapaku i pllakës qarkore (por jo kapaku i kaçavidës).

## 4. Llogaritjet dhe dokumentacioni

Llogaritja e kalibrimit mund të bëhet nga (programi kompjuterik) software-i i dërguar nga Universiteti Norvegjez Bujqësor, Departamenti Hartografik i Shkencave. Ky software është vendosur në P-drive at KCA: P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\Program.

### 4.1 Krijimi i 2 folderëve dhe një dosjeje (file)


Duhet të krijohen dy folderët e parë dhe një dosje (file):

- Në folderin P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\Projects\_Paths\_Log krijoni një folder të ri. Kërkoni numrin serik të instrumentit dhe

datën e matjeve (shembull Snr686376\_150603). Ky folder do të shfrytëzohet për projekt file-in. Këtu, gjithashtu është ruajtur edhe log-file-i (dokumentacioni) automatikisht nga llogaritja.

- Në folderin P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\EDM\_Observations krijoni një folder të ri. Kërkonit atë nga data e observimit (vrojtimit) (shembull 150603).
- Nga folderi P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\EDM\_Observations\201103 kopjoni file-in TCR303\_686376.obs në folderin e fundit, të cilin e keni krijuar. Ky file përmban disa observime të vjetra nga bazat në Novobërde. Duhet ta riemërtuni file-in. Emëroni atë sipas numrit serik të instrumentit dhe hapeni atë nga programi *notepad*. Pastaj, ndryshoni observimet sipas vlerave tuaja. Me rëndësi: Vlerat e temperaturës dhe shtypjes për instrumentin dhe reflektorin duhet të janë mesatare (Teorikisht ne duhet të kërkojmë dhe duhet të kemi mesataren e temperaturës për çdo metër të sinjalit në mes instrumentit dhe reflektorit. Që të kemi matje mesatare për instrumentin dhe reflektorin kemi qasje të mjaftueshme, dhe e vëtmja mënyrë praktike është të vendoset për këto vlera të rëndësishme). Mbani mend që duhet ti ruani.

## 4.2 Definicioni i projektit (Project definition)



Filloni programin duke klikuar dy herë në exe-file-in në folder-in P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\Program (file basis3\_2.exe). Shtypni sustën *Project file*. Do të shfaqet kjo pamje:

Shtypni *Project ID*-në për shembull kërkonit atë me numrin serik të instrumentit dhe datën e matjeve. Pastaj duhet të zgjidhni 3 file-a për llogaritjet (përdorni sustat *Choose file* në gjysmën e poshtme të pamjes (ekranit):

- Zgjidhni definicionin

**Baseline** në file-in **novoberde.fas** nga folder-i

P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\BaselineDefinition\_Fasit. Ky file përmban distancat për bazat e matura me instrumentin e saktë Kern Mekometer ME5000 në vjeshtën e vitit 2002, nga Autoriteti hartografik norvegjez. Këto vlera konsiderohen si të saktë dhe duhet të janë të besueshme.

- Zgjidhni instrument file-in EDM në **Leica\_TCR303.EDM** nga folder-i P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\EDM\_Instrument\_File. Ky file përban informata të përgjithshme rreth Leica TCR303 (vlerat janë gjithashtu valide për instrumentet TCR 305 dhe për instrumentet TCR307).

Nëse keni ndonjë lloj tjetër të instrumentit, duhet të bëni një kopje të këtij file-i, ta riemërtuni atë dhe të ndryshoni disa vlera në file – veçanërisht:

L: 0,78 Vala bartëse në mikrometër.

Informacioni rreth gjatësisë valore zakonisht gjendet në shfrytëzuesin e manualit të instrumentit. Ky informacion do të ketë ndikim në përcaktimin e gabimeve qarkore.

Pastaj këtë fajl të ri do ta shfrytëzoni në llogaritje në vend të fajlit **Leica\_TCR303.EDM**.

- Zgjidhni fajlin e vrojtimit *Observation file* të cilin e keni krijuar 4.1 nga folderi të cilin e keni krijuar në 4.1 si një nënfolder nën folderin P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\EDM\_Observations

Pastaj e ruani fajlin e projektit duke shfrytëzuar File (folderi i sipërm në këndin e majtë), dhe Save As... në folderin të cilin e keni krijuar në 4.1 si një nënfolder nën folderin P:\MCO\_Support\_Unit\Basis\Projects\_Paths\_Log. Fajlit mund t'i jepni emrin e njëjtë sikur atij të folderit. Ekstensioni automatikisht do të jetë .bpr.

### 4.3 Llogaritja – prezantimi në log-file

Tani jeni gati të filloni llogaritjet – shtypni sustën Start që të filloni llogaritjet.

Pastaj përcillni instrukzionet në software. Kur të paraqitet pyetja “Do you trust the given distances?” (A janë të sakta distancat e dhëna), duhet të përgjigjeni po. Pranoni propozimet dhe rekomandimet.

Mund ta shihni prezantimin grafik të gabimeve për distancat e ndryshme gjatë llogaritjes.

Vazhdoni deri sa të keni pamjen e zbrazët. Pastaj mbyllni programin duke shfrytëzuar X në këndin e djathtë të epërm. Do të krijohet automatikisht një log-file në të njëtin folder të cilin e keni ruajtur me emrin .bpr fajl (shihni 4.2). Ky fajl mund të hapet dhe të shtyhet në software-in Notepad. Si shembull, shihni shtojcën 3.

## 5. Analiza e rezultateve

Duhet ti analizoni rezultatet e paraqitura në log-file.

Pjesa e parë është dokumentacioni i vrojtimit (observimit) dhe disa llogaritje themelore të të dhënave të krahasuara në fajlin *Baseline Definition file* dhe fajlin e instrumentit EDM.

Nëse i keni përcjell sugjerimet nga software-i, gjatë llogaritjes mundësia (probabiliteti) e konkludimit të gabuar është vënë në 0.05. Ky është nivel i rëndësishë së testeve që i ka kryer programi. Kjo do të thotë se 5% është mundësia (probabiliteti) për përjashtimin e vrojtimit të mirë. Nëse ky probabilitet zvogëlohet, do të rritet probabiliteti i pranimit të një observimi me një gabim më të madh!

Pastaj vjen informacioni rreth gjetjes së gabimit të instrumentit.

Parametrat:

Konstanta Zero                    a

Shkalla e përpjesëtimit        m

Afati i shkurtër kohor 1    s

Afati i shkurtër kohor 2    r

**Nëse njëra nga këto vlera devijojnë nga 0, është gjetur gabimi signifikant!**

Do të shfrytëzohet formula në vijim:

$$Dc = Dm + a + m*Dm + s*\sin(f) + r*\cos(f)$$

Dc = Distanca e përmirësuar

Dm = Distanca e matur

f = faza =  $(2*Dm-n*I)*(2*\pi/l)$

n = têrësia e  $(2*Dm/l)$

I = Vala e regulluar/periudha për gabimin e shkurtër periodik

Në fund të log-file-it është bërë lista e çdo vlere standarde të devijimit të distancës së matur rreth 1 km. Ky është gabimi i pritur pas përmirësimit të gabimit signifikant të instrumentit, i cili është gjetur – duke shfrytëzuar formulën për Dc (është vënë më lartë në listë). Nëse janë gjetur gabime signifikante, kjo vlerë do të jetë më e vogël se vlera korresponduese për devijimin standard të vlerësuar nga distanca 1 km e matur, pa ndonjë përmirësim, i vënë në listë në fillim të log-file-it.

## 6. Certifikata

AKK-ja do tē lëshojë certifikatën pér instrumentet e kalibruara në baza (shihni shtojcën 4). Një log-file i aprovar pér instrumentin do tē ketë një certifikatë të mbyllur. Të dyja certifikatat dhe çdo faqe e log-file-it të mbyllur do tē ketë datën dhe do tē nënshkruhet nga menaxheri i caktuar nga AKK-ja. Certifikata vlen 1 vit.

## **Shtojca 1 – Formulari për matjet në terren (1)**

Data: ..... Nënshkrimi i gjeodetit: .....

Instrumenti(et), nr serik.: .....

**Shtojca 2. Formulari për matjet në terren (2)**

Data: ..... Nënshkrimi i gjeodetit: .....

Instrumenti(et) nr. serik: .....

Nga - Deri	Lartësia e Instrumentit	Distanca	Lartësia e Reflektorit
1 - 2			
1 - 3			
1 - 4			
1 - 5			
1 - 6			
1 - 7			
2 - 3			
2 - 4			
2 - 5			
2 - 6			
2 - 7			
3 - 4			
3 - 5			
3 - 7			
4 - 5			
4 - 6			
4 - 7			
5 - 6			
5 - 7			
6 - 7			

## **Shtojca 3 – Dokumentacioni, log-file-i**

Sipas instrumentit. Nuk aplikohen përmirësimë të reja.

Nga	Deri	PPM	E observuar	E llogaritur	
<b>Llog.-Obs:</b>					
1	2	21,41	39,1748	39,1755	0,0007
1	3	21,41	234,6895	234,6898	0,0002
1	4	21,41	508,5108	508,5122	0,0013
1	5	21,41	619,9462	619,9500	0,0037
1	6	21,79	1295,9212	1295,9233	0,0021
1	7	23,30	1834,4827	1834,4844	0,0016
2	3	21,41	195,5186	195,5198	0,0011
2	4	21,41	469,3400	469,3418	0,0017
2	5	21,41	580,7749	580,7794	0,0044
2	6	21,79	1256,7513	1256,7543	0,0029
2	7	23,30	1795,3338	1795,3371	0,0032
3	4	21,41	273,8633	273,8649	0,0015
3	5	21,41	385,3042	385,3086	0,0043
3	7	23,30	1600,0327	1600,0370	0,0042
4	5	22,17	111,4434	111,4462	0,0027
4	6	22,54	787,4172	787,4197	0,0025
4	7	23,67	1326,2554	1326,2577	0,0023
5	6	22,07	675,9779	675,9782	0,0003
5	7	23,20	1214,8611	1214,8626	0,0014
6	7	22,64	539,8217	539,8252	0,0034

Shuma e katroreve minimum të matjeve - gabimet = 0,000201  
 Devijimi standard i vlerësuar në 1 km = 0,0032 m  
 Devijimi standard prioritari 1 km = 0,0020 m

E llogaritur F = 2,5162      Probabiliteti = 0,9997

Gabimet e mundshme në koeficientet e instrumenteve,  
 devijimi standard prioritari, matjet e linjës bazë.

### TESTI GLOBAL

Të gjithë fiksat e kundërt Ofset (Offset), Shkalla dhe  
 gabimi i lirë ciklik

Shkalla e lirë	Shuma e katorrit të matur të gabimeve
20	0,000201
16	0,000050

E llogaritur F = 12,22      Probabiliteti = 1,00

Vlerat e reja për EDMI/ duhet të vlerësohen parametrat e  
 linjës bazë.

Verifikimi i veçantë

Probabiliteti i konkludimit të gabuar = 0,05

PARAMETRAT E NXJERRUR GJATË TESTIT:

Konst. Zero

Shkalla

Afati i shkurtër kohor 1

Afati i shkurtër kohor 2

Nga	Deri	v	qvv	Nabla	t	vPv	p
1	2	1,3	0,149	-2,4	2,14	38,1	0,975
1	3	1,2	0,273	-1,7	1,32	44,5	0,897
1	4	1,0	0,488	-1,2	0,84	47,4	0,792
1	5	-1,6	0,541	2,0	1,27	44,8	0,888
1	6	0,9	1,176	-1,0	0,46	49,0	0,673
1	7	1,8	1,650	-2,2	0,80	47,6	0,783
2	3	0,5	0,273	-0,6	0,52	48,8	0,694
2	4	0,4	0,440	-0,5	0,36	49,2	0,637
2	5	-2,1	0,527	2,5	1,74	41,3	0,949
2	6	-0,2	1,137	0,2	0,10	49,6	0,540
2	7	0,0	1,658	0,0	0,00	49,6	0,502
3	4	-0,2	0,259	0,2	0,16	49,6	0,564
3	5	-2,3	0,361	3,0	2,46	35,3	0,987
3	7	-1,6	1,375	1,9	0,76	47,8	0,769
4	5	-1,0	0,225	1,4	1,24	45,1	0,882
4	6	0,1	0,723	-0,1	0,04	49,6	0,516
4	7	0,7	1,070	-0,8	0,35	49,2	0,635
5	6	1,5	0,560	-1,9	1,14	45,7	0,864
5	7	1,4	1,107	-1,5	0,74	47,9	0,766
6	7	-1,2	0,499	1,5	1,00	46,6	0,833

Gabimi trashanik i mundshëm kur  $p > 0,998735$

DUKE KËRKUAR KOMBINIMET MË TË MUNDSHME TË PARAMETRAVE

KOMBINIMI MË I PËRSHTATSHËM I PARAMETRIT:

Konst. Zero

Shkalla e lirë Shuma e katrorit të matur të gabimeve

16	0,000050
19	0,000057

E llogaritur  $F = 0,8181$  Probabiliteti = 0,4972

Rekomandohen këta parametra. Duhet të mbaroj kërkimi.

**NR. AKK 2005/07 • EDM KALIBRIMI I INSTRUMENTEVE NË  
BAZËN KONTROLLUESE ZYRTARE**

---

REZULTATET E LLOGARITURA - TË PËRSHTATURA:

COFACTOR MATRIX:

0,0306

VLERAT E VLERËSUARA ME DEVIJIM STANDARD DHE KUFIZIMET e SIGURTA:

Probabiliteti në bërjen e konkludimit të gabuar = 0,050

Konst. zero = 0,0021

Devijimi standard = 0,0003

0,950 limiti konfident 0,0015 0,0027

Shuma e katrorit të matur të gabimeve = 0,000057

Devijimi standard ( distanca 1 km ) = 0,0017 m

Shkalla e lirë = 19

FORMULA PËR LLOGARITJE

Parametrat:

Konst. zero a = 0.0021 m

Shkalla e përpjesëtimit m = 0.0000 m/km

Afati i shkurtër kohor 1 s = 0.0000 m

Afati i shkurtër kohor 2 r = 0.0000 m

Formula përmirësuese:

$$Dc = Dm + a + m \cdot Dm + s \cdot \sin(f) + r \cdot \cos(f)$$

Dc = Distanca e përmirësuar

Dm = Distanca e matur

$$f = faza = (2 \cdot Dm - n \cdot l) \cdot (2 \cdot \pi / l)$$

$$n = \text{Integeri i } (2 \cdot Dm / l)$$

$$l = \text{Vala e ulët/periudha për gabimin e shkurtër kohor}$$

BESUESHMËRIA

Devijimi standard 1 km (i vlerësuar) = 0,0017

Parametri ekscentrik (jo qendror t) = 4,4977

Gabimi trashanik më i madh i vlerësuar në kolonën e tretë.  
Gabimi trashanik më i madh i vlerësuar ndikon që parametrat  
të jenë në kolonën vijuese:

Konstant. Zero

1	2	0,0055	0,0006
1	3	0,0057	0,0005
1	4	0,0064	0,0003
1	5	0,0070	0,0003
1	6	0,0095	0,0002
1	7	0,0122	0,0002
2	3	0,0053	0,0005
2	4	0,0064	0,0004
2	5	0,0067	0,0003
2	6	0,0093	0,0002
2	7	0,0118	0,0002
3	4	0,0062	0,0005
3	5	0,0062	0,0004
3	7	0,0113	0,0002
4	5	0,0051	0,0005
4	6	0,0073	0,0003
4	7	0,0102	0,0002
5	6	0,0073	0,0003
5	7	0,0091	0,0002
6	7	0,0066	0,0003

Numrat më të mëdhenj nga tabela:

Stacioni Shenja Besueshmëria Në

1 7 0,0122 Observimi

1 2 0,0006 Konstanta Zero

## Shtojca 4 – Certifikata

# Certifikata

## AKK

Vërteton që Matësi Elektronik i Distancës (**EDM**)

Emri i instrumentit: .....

Prodhim i: ..... me numër serik:.....

.....  
(me datë)

është kalibruar në Bazën kalibruese zyrtare në Novobërdë

Llogaritjet janë bërë nga AKK-ja, duke shfrytëzuar software-in e  
aprovar


Dokumentacioni i mbyllur nga llogaritjet

Prishtinë .....  
(data)

.....  
(nënshkrimi)

### Shtojca 5. Harta me lokacionin (vendin) e pikave të bazës kalibruese-Novobërdë

Në këtë hartë topografike të "Janjevës" dhe "Novo Bërdës" në shkallë 1:25,000 lëshuar në vitin 1970 janë paragjitur pikat e bazës kalibruese



Kjo kornizë hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe shpalljes

Prishtinë 20.05.2005

KRYESHEFI EKZEKUTIV  
Prof. Dr. Sc Murat Meha



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI  
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS  
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA  
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

**KORNIZA  
Nr. AKK 2005/08**

**HARTAT E SKANUARA DHE TË  
GJEOREFERENCUARA**

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke u bazuar në Nenin 34.2 të Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 dhjetor 2003 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/04 dhe Nenit 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/08 për Zbatimin e Ligjit mbi Kadastrin Nr. 2003/25, me 20.05.2005 aprovon këtë Kornizë si vijon

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>133</b>
<b>2. GJEOREFERENCIMI ME TRANSFORMIM AFFIN.....</b>	<b>134</b>
2.1 FILLIMI I RxSPOTLIGHT COLOR PRO .....	134
2.2 PROCEDURA: .....	134
2.3 HAPJA E DOSJES SË RASTERIT .....	135
2.4 DEFINIMI I SISTEMIT KOORDINAT (UCS) .....	136
2.5 DEFINIMI I RUBBER SHEET SETTINGS .....	137
<b>3. GJEOREFERENCIMI I TOPOHARTAVE NË SERVERIN E AKK .....</b>	<b>139</b>
3.1 OBJEKTIVAT .....	139
3.2 SISTEMI I REFERIMIT .....	139
3.3 PROCEDURAT .....	141

## 1. Hyrje


Kjo kornizë merret me gjeoreferencimin e hartave kadastrale dhe hartave topografike (topohartat).

Deformimet e hartave të skanuara Kadastrale kërkojnë gjeoreferencim me anë të transformimeve “affin”. Për këtë qëllim programi RasterEx është i përshtatshëm. Hapat e përdorimit janë përshkruar në këtë kornizë e gjithashtu në **Kornizën për vektorizimin e parcelave në Geomedia/GeosPro 2005/09**.

